



ERRU

Enti Rregullator i Ujit

BILANCI I UJIT

VITI 2025



KURSEJ
ÇDO PIKË



MBROJMË
BURIMET



SË BASHKU
PËR TË
ARDHMEN



Tiranë, 2026

Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. "Viktor Eftimiu" Nd. 1, Njësia Administrative Nr.5, 1022
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 42 258 046
Faqja e internetit: www.erru.al
©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Gusht 2026

PËRMBAJTJA

1. Të Përgjithshme	4
2. Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.	7
2.1 Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij.....	8
2.2 Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqëritë Rajonale në shkallë vendi	9
3. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Berat sh.a.	11
4. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Dibër sh.a.	16
5. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Durrës sh.a.	21
6. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan	26
7. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a	30
8. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë	34
9. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Korçë sh.a	38
10. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale Kukës sh.a	43
11. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a	47
12. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lushnjë sh.a	51
13. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec	55
14. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë sh.a	60
15. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër sh.a.	64
16. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Vlorë sh.a.	69
17. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Tiranë sh.a.	73
18. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Vorë sh.a.	78
19. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Kamëz sh.a	82
ANEKSI 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe 2025.....	87
ANEKSI 2. Tabela Përmbledhëse e Bilancit të Ujit për çdo Shoqëri viti 2025	88

LISTA E TABELAVE

Tabela nr. 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve Kombëtare për vitin 2025.....	6
Tabela nr. 2. Bilanci i Ujit sipas IWA-s.....	8
Tabela nr 3. Bilanci i Ujit në nivel kombëtar për vitin 2025.....	9
Tabela nr. 4. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe	12
Tabela nr. 5. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	13
Tabela nr. 6. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Berat sh.a. - Viti 2025	14
Tabela nr. 7. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe	17
Tabela nr. 9. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Dibër - Viti 2025	18
Tabela nr. 10. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	22
Tabela nr. 11. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	22
Tabela nr. 12. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës - Viti 2025	23
Tabela nr. 13. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe	26
Tabela nr. 14. Konsumi i Faturuar për konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve	26
Tabela nr. 15. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan - Viti 2025.....	27
Tabela nr. 16. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe	31
Tabela nr. 17. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve	31
Tabela nr. 18. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a. - Viti 2025.....	32
Tabela nr. 19. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe	34
Tabela nr. 20. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	35
Tabela nr. 21. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë – Viti 2025	36
Tabela nr. 22. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	39
Tabela nr. 23. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	39
Tabela nr. 24. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Korçë – Viti 2025	40
Tabela nr. 25. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	43
Tabela nr. 26. Konsumi i faturuar për konsumatorët familjare dhe disponibiliteti i burimeve.....	44
Tabela nr. 27. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Kukës sh.a. – Viti 2025.....	44
Tabela nr. 28. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	47
Tabela nr. 29. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	48
Tabela nr. 30. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a. – Viti 2025	49
Tabela nr. 31. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	52
Tabela nr. 32. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve.....	52
Tabela nr. 33. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lushnjë sh.a – Viti 2025	53
Tabela nr. 34. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	56

Tabela nr. 35. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	56
Tabela nr. 36. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec sh.a.– Viti 2025.....	57
Tabela nr. 37. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	61
Tabela nr. 38. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	61
Tabela nr. 39. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë sh.a – Viti 2025	62
Tabela nr. 40. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfes	65
Tabela nr. 41. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	65
Tabela nr. 42. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër sh.a. – Viti 2025	66
Tabela nr. 43. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe	69
Tabela nr. 44. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	70
Tabela nr. 45. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë sh.a – Viti 2025.....	71
Tabela nr. 46. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	74
Tabela nr. 47. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	74
Tabela nr. 48. Bilancit i Ujit për Shoqërinë UK Tiranë- Viti 2025.....	75
Tabela nr. 49. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	78
Tabela nr. 50. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	79
Tabela nr. 51. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Vorë sh.a. – Viti 2025.....	80
Tabela nr. 52. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe	83
Tabela nr. 53. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve	83
Tabela nr. 54. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Kamëz – Viti 2025	85

1. Të Përgjithshme

Gjatë viteve të fundit, sektori i furnizimit me ujë në Shqipëri ka kaluar një proces të rëndësishëm transformimi, i orientuar drejt rritjes së efikasitetit operacional, qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimit. Konsolidimi i shoqërive rajonale të ujësjellësit, dixhitalizimi i proceseve operacionale dhe përafrimi me standardet e Bashkimit Evropian kanë rritur rolin e Bilancit të Ujit nga një detyrim raportues në një instrument të domosdoshëm për menaxhimin strategjik të sistemit. Një nga sfidat më kritike të sektorit të ujësjellës-kanalizimeve në kontekstin e Shqipërisë është menaxhimi i humbjeve të ujit, ose Ujit Pa të Ardhura UPA, i cili duhet parë si pjesë e strategjive të adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike.

Bilanci i Ujit përfaqëson metodologjinë standarde për vlerësimin e mënyrës së përdorimit të burimeve ujore, duke analizuar të gjithë ciklin e ujit – nga prodhimi ose marrja në burim deri te konsumi i faturuar dhe humbjet në rrjet. Përmes këtij procesi evidentohen jo vetëm humbjet fizike, por edhe mangësitë administrative, gabimet e matjes dhe problematikat që ndikojnë në performancën financiare të operatorit.

Reduktimi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) mbetet një nga prioritetet kryesore të reformave në sektorin e ujit. Shumica e operatorëve vazhdojnë të përballen me nivele të larta humbesh, të shkaktuara nga amortizimi i rrjeteve, lidhjet e paligjshme, pasaktësitë në matje dhe menaxhimi jo i plotë i presioneve. Për këtë arsye, janë orientuar drejt investimeve për rehabilitimin e rrjeteve, krijimit të Zonave të Matjes së Pavarur (DMA), instalimit të matësve inteligjentë dhe sistemeve të monitorimit në kohë reale.

Në Shqipëri, procesi i rajonalizimit të shoqërive të ujësjellësit ka krijuar një realitet të ri operativ, ku monitorimi i performancës nuk mbështetet më vetëm në tregues financiarë, por edhe në indikatorë teknikë të standardizuar, ndër të cilët Bilanci i Ujit dhe niveli i Ujit Pa të Ardhura zënë vend kryesor. Kjo kërkon një cilësi më të lartë të të dhënave, standardizim të procedurave të matjes dhe raportim të unifikuar në përputhje me metodologjinë e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujit (IWA).

Bilanci i Ujit konsiderohet jo vetëm një dokument raportues, por një mjet vendimmarrës për planifikimin e investimeve, priorizimin e ndërhyrjeve në rrjet, optimizimin e burimeve financiare dhe monitorimin e rezultateve të programeve të reduktimit të humbjeve. Analiza e tij mbështet hartimin e planeve të performancës, rritjen e qëndrueshmërisë së furnizimit me ujë dhe përmbushjen e objektivave të zhvillimit të sektorit. Për të 14-in vit radhazi, ERRU si institucioni që ka një rol kyç në ruajtjen e efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së sektorit të ujit në tërësi, hartoi raportin e Bilancit të Ujit, aktualisht për vitin 2025. Ky raport, informon dhe bën transparencë për publikun dhe të gjitha palët e interesuara në nivel qendror dhe vendor të përfshira në sektorin e ujit në Shqipëri, mbi nivelin e UPA si një nga treguesit kryesor të performancës.

UPA është targetuar si indikator që luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në qëndrueshmërinë teknike dhe financiare të shoqërive që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë, por dhe në cilësinë e shërbimit ndaj

konsumatorit, si edhe në mbrojtjen e burimeve ujore. UPA në thelb është një koncept financiar dhe operimi që përfshin gjithë sasinë e ujit që nuk sjell të ardhura për shoqërinë, edhe nëse nuk është sasia reale e ujit të humbur fizikisht. Megjithatë ky tregues nga mënyra se si llogaritet dhe raportohet lidhet kryesisht me faktor strukturor dhe operacional të cilët janë:

- Amortizimi i rrjetit shpërndarës, ku një pjesë e konsiderueshme e tubacioneve janë të vjetruara dhe të ekspozuar ndaj rrjedhjeve;
- Mungesa e kontrollit të presionit në rrjet, çka rrit probabilitetin e çarjeve dhe rrjedhjeve;
- Defekte dhe rrjedhje në depozita, nyje lidhëse dhe stacione pompimi;
- Mungesa e matësve të debitit në pikat kryesore të sistemit, duke e bërë të pamundur monitorimin e saktë të ujit të prodhuar dhe të shpërndarë;
- Mungesa e ndarjes së rrjetit në zona matjeje (DMA), që vështirëson identifikimin dhe lokalizimin e humbjeve.

Në përfundim, reduktimi i humbjeve teknike kërkon një qasje të integruar që kombinon përmirësimet infrastrukturore me rritjen e kapaciteteve monitoruese dhe menaxheriale të sistemeve. Reduktimi i humbjeve të ujit nuk është vetëm një sfidë teknike, por një domosdoshmëri strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të ujit në Shqipëri. Menaxhimi efektiv i ujit të pijshëm nuk mund të kuptohet pa një bilanc të saktë dhe të rregullt të ujit. Ai ndihmon në përmirësimin e performancës së çdo shoqëri rajonale, reduktimin e humbjeve dhe garantimin e shërbimit të qëndrueshëm për qytetarët.

ERRU thekson se Bilanci i Ujit nuk duhet të trajtohet si një raport statistikor nga shoqëritë e ujësjellësve por si një instrument operacional dhe financiar për menaxhimin e UPA, eficiencës së energjisë, dhe performancës së sistemeve të ujësjellësve. ERRU thekson se, përkushtimi gjatë hartimit të Bilancit të Ujit, vlerësimi i komponentëve përbërës të tij, bazuar në matje apo vlerësime sa më pranë vlerave reale, është përcaktues në saktësinë e nivelit të Ujit Pa të Ardhura të çdo shoqërie UK, dhe në nivel kombëtar. Për vitin 2025, u konstatua se “shërbimi i furnizimit me ujë” realizohet për 79.6 % të popullsisë në juridiksion. Shoqëritë UK kanë prodhuar 302,484,190 m³ ujë, nga të cilat 56.1% raportohet i matur dhe 43.9% i vlerësuar.

Uji Pa të Ardhura në rang sektori qëndron në nivele të pakënaqshme edhe për këtë vit, në nivelin e 61 %. Humbjet Reale përbëjnë 53.3 % të humbjeve të përgjithshme ndërsa Humbjet Administrative 46.7 % të tyre. Konsumi i Autorizuar Total rezultoi 117,306,958 m³ ujë. Konsumi i Autorizuar i Faturuar matet në nivelin 80.36% nga 78% që ka rezultuar në vitin 2024. Konsumi i Autorizuar i Pa Faturuar, përbën 1.02 % të Ujit të prodhuar. Humbjet nga prezenca e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e transmetimit dhe të shpërndarjes përbëjnë 60.6% të humbjeve administrative nga 63.4 % që ishin në vitin 2024, ndërsa humbjet nga pasaktësia në matje në prodhim dhe konsumatorë rezultuan me rritje në nivelin 39.4% nga 30.2% që rezultonin në vitin 2024.

Të dhëna të përgjithshme, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, në shkallë vendi jepen në Tabelën 1. Nga të dhënat e Tabelës 1, referuar raportimeve të shoqërive pranë sektorit të monitorimit për numrin e popullsisë të shërbyer apo në juridiksion konstatohet se, sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor në shkallë vendi prej 65.73 l/ditë për banorë, apo konsumit total që rezulton 69.16 /ditë për banor, në të dy rastet mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e çdo shoqërie. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të CENSUS-it 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacionale.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve Kombëtare për vitin 2025

Popullsia		Burimet - Kapaciteti i tyre (Kapaciteti shfrytëzues i burimeve ujore për ujë të pijshëm) (në m ³ /vit)	Uji i Prodhuar që futët në sistem (në m ³)	Konsumi i ujit të pijshëm për popullsinë			Numri i lidhje të shërbimit		Konsumi i ujit të pijshëm për banorë		
E regjistruar në zonën e shërbimit*	E shërbyer*			Total (në m ³)	I matur (m ³)	I pamatur (aforfe) (m ³)	Me matës (aforfe)	Pa matës (aforfe)	I matur l/banor/ditë	I pamatur (aforfe) l/banor/ditë	Total (i matur & aforfe) (l/ditë /banor)
4,460,042	3,548,829	667,938,852	302,484,190	89,589,200	75,281,638	14,307,562	797,901	103,922	65.73	95.22	69.16

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU

Nga tabela nr. 1, shihet se në shkallë vendi ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë të popullatës. Prodhimi i ujit në litra/ditë, për banor përgjithësisht është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë 24/7 të banorëve.

Në fokusin e shoqërive rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit për të arritur objektivin kombëtar për nivelin e UPA, realizimin e qëllimit final "kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7" për çdo njësi furnizimi, si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

Theksojmë se të dhënat për popullsinë në juridiksion dhe për popullsinë me shërbim, si bazë për llogaritje janë marrë sipas raportimit nga shoqëritë pranë ERRU-së, ndaj duhet insistuar në saktësimin e këtyre të dhënave, të cilat janë bazë në analizën dhe vlerësimin real të disponueshmërisë së burimeve ujore, që shërbejnë për furnizimin e popullatës.

Analiza në vijim nxjerr në pah gjithë problematikat mbi Bilancin e Ujit, UPA dhe nën komponentët përbërës të tij, për çdo shoqëri.

2. Metodologjia e Hartimit të Bilancit të Ujit.

Në zbatim të Vendimit nr. 46, datë 27.12.2013 të Komisionit Kombëtar Rregullator, çdo shoqëri UK që operon në Shqipëri duhet të vlerësojë dhe monitorojë humbjet e ujit duke hartuar formatin “Bilanci i Ujit”, të dhënat e të cilit përpunohen nga sektori teknik dhe licencave pranë ERRU-së. Hartimi i Raportit u zhvillua sipas procedurës që përcakton të gjithë hapat si: grumbullimin, përpunimin, dorëzimin nga shoqëritë e ujësjellës kanalizime të të dhënave sipas formatit të miratuar nga ky vendim dhe vijon me verifikimin, shqyrtimin nga ERRU deri në miratimin e tij nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Hartimi i Bilancit të Ujit bëhet duke respektuar formatin e Shoqatës Ndërkombëtare të Ujësjellësve (International Water Association , IWA). Referuar metodologjisë së IWA bilanci i ujit përdoret si standard për menaxhimin e humbjeve dhe eficiencës së sistemeve të ujësjellësit. Qëllimi kryesor në respektimin e këtij formati është unifikimi i metodologjisë dhe terminologjisë për të gjithë shoqëritë UK duke i vendosur ato në të njëjtat kushte vlerësimi për secilin nga komponentët e bilancit të ujit.

Bilanci i ujit të pijshëm hartohet për të evidentuar dhe analizuar flukset e ujit në sistemet e furnizimit me ujë, për të identifikuar humbjet reale dhe administrative, si dhe për të mbështetur planifikimin strategjik, investimet infrastrukturore dhe rritjen e eficiencës së shërbimit ndaj konsumatorit. Aktualisht për hartimin e bilancit të ujit nga shoqëritë UK vazhdon të përdoret metoda e hartimit të komponentëve nga “lart-poshtë” (top-down) e cila nis nga përlllogaritja e Konsumit të Autorizuar të ujit dhe më tej vazhdon me llogaritjen e Humbjeve të Dukshme ose Humbjeve Administrative. Përcaktimi i Humbjeve Reale ose Fizike sipas kësaj metodologjie kryhet me deduksion.

Në shoqëritë e ujësjellësve të përparuar, me rrjete inxhinierike me matje dhe me teknologjinë e duhur të monitorimit dhe kontrollit të nivelit të humbjeve në çdo pjesë të sistemit, përdoret metoda nga “poshtë lart” (down-top). Zbatimi i vlerësimit nga poshtë lart të humbjeve reale nuk mund të kryhet në rastin e furnizimeve me ujë me ndërprerje, pasi regjimi i furnizimit është i ndërprerë dhe maskohet shumë nga kërkesa gjatë periudhës kohore të kufizuar të furnizimit ndaj nuk mund të zbatohet ende nga asnjë prej shoqërive që operojnë në vendin tonë.

Në tabelën nr. 2, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit të cilat llogariten duke u bazuar në të dhënat e grupuara vjetore nga çdo shoqëri UK.

Tabela nr. 2. Bilanci i Ujit sipas IWA-s

Uji Prodhuar nga Burimet e Veta	Volumi i Ujit që Hyn në Sistem	Konsumi i Autorizuar	Konsumi i Autorizuar, i Faturuar	Uji i eksportuar	Uji me të Ardhura
				Konsum i matur	
				Konsum i pamatur	
			Konsum i Autorizuar, i Pa Faturuar	Konsum i matur	Uji Pa të Ardhura
				Konsum i pamatur	
				Konsum i paautorizuar	
Uji Eksportuar (i blerë)		Humbjet e Ujit	Humbjet Administrative	Pasaktësia në ujëmatëse	
				Gabime sistematike në trajtimin e të dhënave	
				Rrjedhjet në tubacionet e transmetimit dhe shpërndarjes	
			Humbjet Teknike	Rrjedhjet dhe derdhjet në depot e Shoqërive	
				Rrjedhjet në lidhjet e shërbimit të konsumatorëve deri në pikën e matjes	

2.1 Bilanci i Ujit, Komponentët Përbërës të Tij

Volumi i ujit që hyn në sistemin e furnizimit konsiderohet sasia e ujit të prodhuar në një vit kalendarik plus sasinë e ujit të blerë me shumicë nga operatorët e tjerë.

Faktorë përcaktues në nivelin real të treguesit UPA për çdo shoqëri UK mbeten matja në nivele të kënaqshme në prodhim apo përkushtimi gjatë procesit të vlerësimit të volumit të prodhuar në pikat ku ujëmatësit mungojnë. Matja vetëm gati e gjysmës së sasisë së ujit që hyn në sistemet e ujësjellësve në shkallë vendi gjatë vitit 2025, si dhe rreziku që ekziston për vet faktin se operatorë nuk zbatojnë siç duhet procedurat gjatë vlerësimit të volumeve të ujit, sjellë si pasojë që treguesi UPA që rezulton i pandryshuar krahasuar me një vit më parë, të jetë në nivele jo të kënaqshme besueshmërie.

ERRU vazhdon të insistojë që shoqëritë UK në mungesë të matësve në burim, kaptazhe, puse, veprat e marrjes nga basenet sipërfaqësorë, si dhe në dalje të stacioneve qendrore të pompimit, të zbatojnë me saktësi dhe përgjegjshmëri procedurat e vlerësimit të volumeve duke u bazuar në rekomandimet teknike.

2.2 Analiza e Ujit Pa të Ardhura (UPA) për Shoqëritë Rajonale në shkallë vendi

Të 14 Shoqëritë Rajonale UK si dhe 3 shoqëritë jo rajonale ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë vetëm për 79.6 % të popullsisë totale nga 77.8 % që ishte në vitin 2024. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 1,007,019 lidhje për vitin 2025 me një rritje prej 26,505 lidhje krahasuar me vitin 2024, nga këto 898,195 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës ose 89.2% nga 87.94 % që rezultonte një vit më parë. Prodhimi vjetor 302,484,190 m³ (331,862 m³ më pak se viti 2024) rezulton i matur në nivelin 56.1% nga 64.8% në vitin 2024, ndaj nevoja për një vlerësim serioz mbi sasinë e ujit që hyn në sistemet e ujësjellësit dhe pajisja me aparate ujëmatës në pikat prodhuese është e domosdoshme për të gjitha burimet e shfrytëzueshme. “Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivelin 61 % të ujit që hyn në sistem, shoqëritë fatojnë vetëm 117,306,958 m³ ujë ose 38.78% të ujit të prodhuar. **Tabela nr. 3**, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, në nivel kombëtar.

Tabela nr 3. Bilanci i Ujit në nivel kombëtar për vitin 2025

Emërtimi		Volumi i Ujit (në m3)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	të matur	169,678,579	56.1%
	të vlerësuar	132,805,611	43.9%
Volumi total i ujit që futet në sistem		302,484,190	100%
Konsumi i ujit të faturuar i matur		94,271,462	31.17%
Konsum i ujit të faturuar të matur që shitet tek të tretë		7,794,000	2.58%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur		15,241,496	5.04%
Faturimi total		117,306,958	38.78%
Konsumi i Ujit te pa faturuar për sistemet zjarrfikës, pastrim deposh etj.		3,083,353	0.00%
a) sistemi zjarrfikës (nëse dhurohet)		1,269,745	0.42%
b) Institucionet fetare dhe bamirësie (kisha, xhami, jetimore, azil, etj.) (nëse dhurohet)		221,620	0.07%
c) Pastrimi i depove dhe i rrugëve		1,591,988	0.53%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar		3,083,353	1.02%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit		16,840,234	5.57%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës		34,699,457	11.47%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	në prodhim	5,908,696	1.95%
	konsumatorë	27,600,241	9.12%
Humbjet e dukshme (administrative)		85,048,628	28.12%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit		15,488,906	5.12%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.		4,941,992	1.63%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit		5,272,646	1.74%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes		51,159,477	16.81%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësijellësit		20,182,230	6.67%
Humbjet Reale të ujit (teknike)		97,045,251	31.97%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)		182,093,879	59.98%
UJI PA TË ARDHURA		185,177,232	61%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 3:

- Treguesi UPA është afërsisht në nivelin 61% të prodhimit vjetor, rezulton në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2024, duke mbetur përsëri larg objektivit të sektorit dhe kërkon angazhime serioze për t'u përmirësuar. Kjo situatë shpjegohet nga fakti se, krahasuar me vitin 2024, sasia e ujit të prodhuar që futet në sistem ka pësuar një rënie prej 331,862 m³, ndërsa faturimi total ka shënuar një rënie edhe më të ndjeshme, prej 876,889 m³. Për rrjedhojë, në terma absolutë, sasia e Ujit Pa të Ardhura rezulton në rritje, por meqenëse ky tregues llogaritet si përqindje ndaj volumit të ujit të prodhuar, i cili gjithashtu u ul, niveli i UPA-s në përqindje mbeti pothuajse i pandryshuar.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i Prodhuar”, është 56.1% nga 64.8% që ishte në vitin 2024 dhe tregon për një përkeqësim të këtij treguesi, pasi vetëm gati gjysma e sasisë së ujit që hyn në sistem matet.
- Konsumi total i faturuar mbetet në nivelin 38.78 % krahasuar me një vit më parë, ku vërehet një përmirësim modest i sasisë së ujit të matur të faturuar në 31.17% nga 30.53 % në vitin 2024.
- Numri i lidhjeve me ujëmatës është 898,195 lidhje ose 89.2% të totalit të klientëve nga 87.94 % që rezultonte një vit më parë, duke treguar përmirësim të këtij treguesi, i cili reflekton një menaxhim më korrekt të kërkesës për ujë.
- Niveli i humbjeve reale 32.08 % paraqitet me tendencë përkeqësimi krahasuar me vitin 2024, që ishte në nivelin 30.16 %. Ajo që vihet re është se mbetet pothuaj i pandryshuar niveli i humbjeve nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin e 16.81% nga 16.30% (pra një tendencë e vogël përkeqësimi) krahasuar me vitin 2024. Analizimi dhe monitorimi i situatës në terren nga ana e çdo shoqërie është domosdoshmëri për uljen e tyre.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 28.12% nga 29.85% në vitin 2024 e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem. Vihet re një ulje e nivelit të humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin e 17.04 % të prodhimit vjetor nga 18.95 % në vitin 2024, ndërsa humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 11.08% nga 10.89%, tregon për një përkeqësim të tyre krahasuar me vitin 2024.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve ende nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërive.
- Stafet e shoqërive në përgjithësi hasin mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

Kjo analizë na tregon qartë se shoqëritë përballen me sfida të mëdha në menaxhimin e ujit. Ndaj duhet që:

- *Shoqëritë të përpiqen seriozisht për reduktimin e nivelit të vlerësimit të ujit duke synuar matjen reale me matës inteligjente, pasi përbindja e lartë e këtij treguesi ul besueshmërinë e bilancit dhe vështirëson identifikimin e humbjeve;*
- *Ndërtimi i sistemeve të monitorimit dhe kontrollit, programe sistematike të detektimit të rrjedhjeve, Instalimi dhe mirëmbajtja e matëseve si në depo ashtu dhe në rrjet dhe tek klientët, duhet të shoqërohet me hartimin e bilanceve javore dhe mujore të ujit të pijshëm;*
- *Të shikohet mundësia që në zonat urbane (qytete) ku ka sisteme SCADA të bëhet monitorim ditor dhe bilanci ditor i ujit;*
- *Të rriten përpjekjet për projektimin dhe realizimin e ndarjes së rrjeteve të ujësjellësit në DMA, dhe instalimi i sistemeve të monitorimit të presionit;*
- *Është e domosdoshme inventarizimi i të gjitha lidhjeve të paligjshme shoqëruar dhe me fushata sensibilizuese për konsumatorët mbi raportimin e defekteve dhe rëndësinë e instalimit dhe ruajtjes së matësve. Zbatimi rigoroz i kontratave dhe tarifave, duke shmangur tolerancën për pagesat e pakryera do të ndikojë në reduktimin e UPA dhe rrisë qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.*

Në kushtet e ndryshimeve klimatike, të përmytjeve apo thatësirave të tej zgjatura, shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve duhet të ndjekin filozofinë “Mos prit që tubi të shpërthejë, gjeje rrjedhjen përpara se të bëhet defekt”. Ato duhet të monitorojnë dhe raportojnë humbjet e ujit dhe të zbatojnë masa për reduktimin e tyre. Për këtë arsye bilanci i ujit nuk duhet të konsiderohet më si një dokument statistikor, por një instrument kryesor për menaxhimin e performancës teknike dhe financiare të tyre. ERRU vazhdon të theksojë se bashkëpunimi midis gjithë palëve të interesuara, përdorimi i praktikave të qëndrueshme dhe investimi në infrastrukturë dhe teknologji të përshtatshme mund të ndihmojnë në zvogëlimin e humbjeve të ujit nga shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve.

3. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Berat sh.a.

Shoqëria rajonale UK Berat e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Berat me 23.01%, Kuçovë me 12.32%, UK Ura Vajguore (Dimal) me 5.39%, UK Poliçan me 3.58%, dhe UK Skrapar me 4.7%. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Berat jepen në tabelën nr. 4.

Nga të dhënat e Tabelës nr.4, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 68.5 l/ditë për banorë dhe sipas faturimit aforfe afërsisht 42.4 l/ditë për banorë, janë shumë të ulëta dhe larg standardit të konsumit prej 150 litra/ditë për banor. Në të dy rastet, niveli i konsumit mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacionalë.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'i kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 4. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Berat	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/dite, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	160,305	3,896,627	3,716,348	180,279	36,613	2,872	68.5	42.4	66.6

Menaxhimi sa me efektiv i burimeve të ujit për konsum publik dhe nga ana tjetër tendenca në rritje të vazhdueshme e kërkesës për ujë, kërkojnë një vlerësim real të këtyre burimeve dhe rezervave që ato kanë në kushtet kur shpesh po përballemi me dukuri tepër shqetësuese për shkak të ndryshimeve klimatike të shoqëruara dhe nga ndryshimet demografike. Ky vlerësim ka si synim evidentimin e këtyre rezervave ujore në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 5, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre për të cilat ende nuk kemi pasi një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 5. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Berat	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m³)	(l/ditë, banor)		(në m³/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	160,305	7,194,857	66.6	228,654	100,446,000	1203.5	1136.9

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU

Nga tabela nr. 5, shihet se shoqëria rajonale UK Berat ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Berat sh.a

Shoqëria Rajonale UK Berat, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Berat - Kuçovë, Poliçan, Skrapar dhe Dimal. Shërbimin i FU i ofrohet 160,305 banorëve ose 70.1 % të popullsisë në juridiksion. Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë për vitin 2025 raportohet 43,125 lidhje nga të cilat 93 % janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Prodhimi vjetor 7,194,857 m³ rezulton i matur në nivelin 20.96 %, nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese është e domosdoshme për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

“Uji Pa të Ardhura” rezultoi në nivelin 37.51 % të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 4,496,393 m³ ujë ose 62.49% të prodhimit. Nga këto të dhëna evidentohet se krahasuar me vitin 2024 shoqëria ruan pothuaj të njëjtat vlera (UPA 37.67% dhe faturimi total 62.33%)

Tabela nr. 6, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Berat.

Tabela nr. 6. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Berat sh.a. - Viti 2025

Emërtimi	Viti 2025	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	1,508,302	20.96%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	5,686,555	79.04%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	7,194,857	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,265,084	59.28%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	231,309	3.21%
Faturimi total	4,496,393	62.49%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	770,141	10.70%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	262,800	3.65%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	336,384	4.68%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	67,800	0.94%
Humbjet e dukshme (administrative)	666,984	9.27%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	170,381	2.37%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	157,680	2.19%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	264,771	3.68%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	292,000	4.06%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	376,507	5.23%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,261,339	17.53%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,928,323	26.80%
UJI PA TË ARDHURA	2,698,464	37.51%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 6:

- Treguesi UPA për vitin 2025 në nivelin 37.51 % siç dhe e cituam më lart mbetet pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2024 (37.67%) Humbjet totale raportohen në nivelin 26.80% të prodhimit vjetor të ujit nga 29.78 % që rezultonin në vitin 2024 duke ruajtur trendin pozitiv/zbritës në tre vitet e fundit.
- Nga humbjet totale rezulton se 9.27% janë humbjet e dukshme (administrative) dhe 17.53% janë humbjet reale (teknike) duke rezultuar në përmirësim krahasuar me vitin 2024 që rezultonin respektivisht në vlerat 11.2 % dhe 18.75 %.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar” në nivelin 40.27% nga 21.6 % në vitin 2024, tregon për një përmirësim të këtij treguesi megjithëse ende larg nivelit 100 % të ujit të matur që hyn në sistem.

- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në linjën e transmetimit në nivelin 3.65% (pothuaj i pandryshuar krahasuar me vitin 2024 që ishin në vlerë 3.56%) nuk konsiderohen të besueshme dhe duhen verifikuar në terren.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës në masën 4.68 % tregojnë një përmirësim modest krahasuar me vitin 2024 që ishin në nivelin (5.49%).
- Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit nën faturim etj. raportohet në vlerën 0.94 % kanë një tendence të vogël përmirësimi pasi në vitin 2024 janë raportuar në masën 1.98%.
- Në humbjet teknike, 4.06% raportohen humbjet për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes e cila ruan pothuaj të njëjtin nivel (një përmirësim pothuaj i pandjeshëm) krahasuar me vitin 2024 e cila ka qenë 4.23 %.
- Konsumatorët familjarë me matje përbëjnë rreth 84 % të numrit total të konsumatorëve, rezultojnë në të njëjtin nivel si viti 2024, dhe për një menaxhim sa më efektiv të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve kryhet në zona të ndara me matje (DMA) vetëm në njësitë Berat (19 DMA) dhe në Kuçovë (16 DMA), por jo në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë dhe kjo sjell në përgjithësi vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

- *Megjithëse është rritur niveli i ujit të prodhuar që matet, shoqëria duhet të vazhdojë të marrë masa për investime në ujëmatës në prodhim qoftë me fonde nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj, për instalimin e tyre në të gjithë burimet që shfrytëzon për prodhimin e ujit.*
- *Vazhdon të mbetet evidente kërkesa për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë për të mundësuar një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit nga stafet përgjegjëse të shoqërisë.*
- *Shoqëria duhet të investojë realisht në burimet njerëzore përgjegjëse për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA ekzistuese si dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale. Gjithashtu të insistohet që Bilanci i Ujit të trajtohet jo thjesht si një statistikë por si analizë reale që evidenton gjithë problematikën që shoqëria ka lidhur me sistemet e ujësjellësit.*

- *Shoqëria duhet të vazhdojë angazhimin e saj për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, duke hartuar një plan veprimi me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, dhe riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit, vihet re një trend pozitiv modest (pra një zvogëlim jo shumë i ndjeshëm i tyre krahasuar me dy vitet e mëparshme), ndaj shoqëria duhet të angazhohet seriozisht dhe në mënyrë koherente për evidentimin e plotë të shkaqeve që sjellin këto humbje, shoqëruar me plane veprimi dhe investime për eliminimin e tyre.*
- *Mbrojtja dhe përdorimi sa më eficient i burimeve të ujit kërkon jo vetëm angazhim konkret nga shoqëria por dhe aktivitete reale për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në përdorimin e qëndrueshëm të ujit, apo aplikimin e metodave teknologjike (celularë) në raportimin real të defekteve apo shpërdorimeve nga vetë klientët.*
- *Në procesin e hartimit të bilancit të ujit shoqëria duhet të bazohet dhe në një nga elementët e saj të veçantë atë të përfshirjes së të gjitha njësive administrative me karakteristika të ndryshme të rrjetit, konsumit dhe nivelit të humbjeve. Ndaj nevojitet një analizë për secilën njësi dhe më pas një vlerësim të konsoliduar në nivel rajonal, duke pasur kështu dhe një guidë në procesin e evidentimit të nivelit të humbjeve në të gjithë zonën e juridiksionit të saj.*
- *Bashkëpunim sa më koherent dhe efektiv i shoqërisë me institucionin e ERRU-së, për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

4. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Dibër sh.a.

Shoqëria rajonale UK Dibër është krijuar si rezultat i bashkimit të ish shoqërive UK ose Njësitë administrative UK Dibër, UK Mat, UK Bulqizë dhe UK Klos. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UK Dibër, paraqiten në Tabelën 7.

Analiza e të dhënave të Tabelës 7, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 75.8 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 117.7 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 7. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Dibër	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor		
Viti 2025	94,316	3,001,000	1,902,000	1,099,000	16,416	6,109	75.8	117.7	87.2

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën 8 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 8. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Dibër	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)				(l/ditë, banor)
2025	94,316	5,491,000	87.2	170,573	14,212,078	228.3	140.1

**Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU*

Bazuar në të dhënat e Tabelës 8, konstatohet se Shoqëria Rajonale UK Dibër disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitë përbërëse. Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Dibër

Shoqëria Rajonale UK Dibër, e krijuar nga bashkimi i ish-shoqërive UK Dibër, Mat, Bulqizë dhe Klos, raporton një popullsi në juridiksion prej 170,573 banorësh, e pandryshuar krahasuar me vitin 2024. Shërbimi i furnizimit me ujë ofrohet për 94,316 banorë, ose 55% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve të furnizimit me ujë është 24,524, nga të cilat 18,022 lidhje, ose 73%, janë të pajisura me ujëmatës nga 66% në vitin 2024, duke regjistruar një përmirësim prej 7%, për klientët të pajisur me matës. Prodhimi vjetor i ujit rezulton 5,491,000 m³ dhe vlerësohet në masën 100%. Pajisja e të gjitha pikave prodhuese me ujëmatës mbetet një nevojë prioritare dhe emergjente për sigurimin e matjeve të sakta dhe përmirësimin e monitorimit të prodhimit.

Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) për vitin 2025 rezulton 34.31% e volumit të ujit të futur në sistem, kundrejt 27.16 % në vitin 2024, duke reflektuar një përkeqësim prej 7.15 %. Shoqëria ka faturuar 3,607,000 m³ ujë, ose 65.69% të volumit të ujit të futur në sistem, krahasuar me 4,644,000 m³ ose 87.84% në vitin 2024. Rënia e volumit të faturuar shpjegohet nga fakti se gjatë vitit 2024 janë reflektuar edhe fatura të prapambetura, të cilat kanë ndikuar në rritje të këtij treguesi. **Tabela nr. 9**, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Dibër.

Tabela nr. 8. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Dibër - Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	0	0%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	5,491,000	100%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	5,491,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,364,000	43.05%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,243,000	22.64%
Faturimi total	3,607,000	65.69%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	105,700	1.92%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	280,000	5.10%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	36,500	0.66%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	785,000	14.30%
Humbjet e dukshme (administrative)	1,101,500	20.06%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	12,500	0.23%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	12,400	0.23%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	1,250	0.02%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	399,150	7.27%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	251,500	4.58%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	676,800	12.33%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,778,300	32.39%
UJI PA TË ARDHURA	1,884,000	34.31%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 9:

- Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (34.31%) paraqet një përkeqësim prej 7.15% krahasuar me vitin 2024. Shoqëria e lidh këtë situatë me uljen e prodhimit të ujit si pasojë e rënies së kapaciteteve të burimeve ujore gjatë vitit 2025, si dhe me ndikimin e faturimeve të prapambetura të reflektuara në vitin 2024.
- Niveli i matjes për komponentin “Uji i Prodhuar” vazhdon të raportohet zero, çka cenon besueshmërinë e vlerave absolute të përdorura në bilancin e ujit dhe kufizon saktësinë e analizës së humbjeve.
- Konsumi total i faturuar përfaqëson 65.69% të ujit të futur në sistem, nga i cili 22.64% përbën konsum të faturuar të pamatur. Krahasuar me vitin 2024, kur ky tregues ishte 72.84%, konstatohet një përkeqësim prej 7.15%, i ndikuar kryesisht nga reflektimi i faturimeve të prapambetura gjatë vitit të mëparshëm.
- Numri i klientëve të pajisur me ujëmatës është 18,022, ose 73.5% e totalit të klientëve të shoqërisë. Konsumatorët familjarë me matje përbëjnë rreth 66.97% të totalit të konsumatorëve. Për një menaxhim më efektiv të kërkesës për ujë dhe një bilanc më të saktë, ky tregues duhet të afrohet sa më shumë me nivelin 100%.
- Humbjet reale rezultojnë në nivelin 12.33%, krahasuar me 8.43% në vitin 2024, duke shënuar një përkeqësim të treguesit. Këto humbje lidhen kryesisht me rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, të cilat përbëjnë 7.27% të volumit të ujit të futur në sistem. Shoqëria duhet të analizojë më tej shkaqet dhe të monitorojë vazhdimisht situatën në terren për identifikimin dhe reduktimin e tyre.
- Humbjet e dukshme arrijnë në 20.06% të volumit të ujit të futur në sistem, ku pjesën më të madhe e zënë pasaktësitë në matje, nën faturimi dhe faktorë të tjerë administrativë, të cilët vlerësohen në nivelin 14.30%.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhen në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk mbështeten ende në zona të ndara matjeje (DMA) në të gjithë territorin e shërbimit.
- Në përgjithësi, stafi përballlet me vështirësi në monitorimin sistematik të humbjeve dhe në hartimin e bilancit të ujit për të gjithë zonën e shërbimit.

Analiza e bilancit të ujit tregon se komponentët kryesorë që ndikojnë në nivelin e humbjeve janë humbjet e dukshme, të shkaktuara nga pasaktësitë në matje, nën faturimi dhe faktorë të tjerë administrativë, të cilat përbëjnë 14.30% të ujit të futur në sistem. Gjithashtu, humbjet reale nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës përfaqësojnë 6.92% të volumit total dhe lidhen kryesisht me amortizimin e rrjetit, veçanërisht në zonat jo urbane. Kjo situatë evidenton nevojën për investime në rehabilitimin e infrastrukturës, rritjen e nivelit të matjes dhe përmirësimin e proceseve të monitorimit dhe menaxhimit të humbjeve të ujit.

Rekomandime:

- *Pajisja me ujëmatës në burim mbetet një nevojë imediate dhe prioritet për përmirësimin e menaxhimit të prodhimit të ujit. Shoqëria duhet të ndërmarë masa urgjente për sigurimin e fondeve, qoftë nga qeveria qendrore apo nga burimet e saj të brendshme, për instalimin e tyre, me qëllim hartimin e një bilanci sa më të saktë dhe real të ujit.*
- *Të intensifikohen përpjekjet për sigurimin e fondeve të nevojshme për projektimin dhe zbatimin e sistemeve DMA në të gjithë zonën e shërbimit, duke mundësuar monitorimin, evidentimin dhe marrjen e masave për reduktimin e humbjeve në sistemin e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci të saktë të ujit.*
- *Shoqëria duhet të sigurojë fonde për rritjen e përqindjes së konsumatorëve familjarë të pajisur me matës, me prioritet instalimin e tyre në banesat private dhe veçanërisht në zonat rurale, ku ky tregues është ende larg nivelit optimal. Kjo do të mundësojë një menaxhim më efikas të kërkesës për ujë dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, të cilat aktualisht raportohen në nivele të ulëta dhe jo gjithmonë të besueshme.*
- *Për lidhjet pa matës, në rastet kur instalimi i tyre nuk është i mundur, duhet të kryhet verifikimi i numrit të banorëve për çdo lidhje nëpërmjet dokumentacionit përkatës (certifikatë familjare), me qëllim faturimin korrekt sipas legjislacionit në fuqi dhe VKM nr. 102, datë 16.03.1992.*
- *Për humbjet reale, të cilat vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, duhet të identifikohen dhe analizohen shkaqet që lidhen me gjendjen teknike të rrjetit. Më tej, të planifikohen dhe sigurohen fondet e nevojshme për rehabilitimin e tij, duke kontribuar në uljen e humbjeve dhe përmirësimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura.*
- *Në lidhje me përqindjen që zënë humbjet që vijnë nga pasaktësia në matjen e ujit në prodhim dhe tek konsumatori dhe nën faturimi etj. të cilat përbëjnë rreth 14.3% të ujit të prodhuar, shoqëria duhet të kryejë një analizë të detajuar për identifikimin e burimit të problematikës. Kjo përfshin kontrollin e saktësisë së matësve, zëvendësimin e matësve të amortizuar dhe monitorimin e procesit të leximit të tyre.*
- *Të vijojë trajnimet e vazhdueshme të stafit teknik në programet kombëtare për menaxhimin e humbjeve të ujit, të organizuara nga SHUKALB dhe institucione të tjera relevante, si dhe të caktojë një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara, me qëllim hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit.*

- *Të krijohen dhe mirëmbahen sistemet e nevojshme të informacionit, në mënyrë që të sigurohet raportim i saktë, i plotë dhe i besueshëm i të dhënave që lidhen me bilancin e ujit dhe çdo informacion tjetër të kërkuar nga institucionet përgjegjëse.*
- *Të forcohet bashkëpunimi me ERRU për adresimin e vështirësive që lidhen me hartimin dhe raportimin e bilancit të ujit, si dhe të sigurohet dorëzimi i tij brenda afateve të përcaktuara. Gjithashtu, të caktohet një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.*

5. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Durrës sh.a.

Shoqëria rajonale UK Durrës përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Durrës, Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Durrës jepen në tabelën nr. 10.

Nga të dhënat e Tabelës nr.10, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 54.7 l/ditë për banorë dhe sipas faturimit aforfe afërsisht 119.1 l/ditë për banorë. Në të dy rastet, niveli i konsumit mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues. Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë.

Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacional.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 9. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Durrës	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi I matur në m ³	Konsumi I pamatur ne m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							I/ditë, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
Viti 2025	506,727	10,711,799	9,628,302	1,083,497	123,204	6,371	54.7	119.1	57.9

Menaxhimi sa me efektiv i burimeve të ujit për konsum publik dhe nga ana tjetër tendenca në rritje të vazhdueshme e kërkesës për ujë, kërkojnë një vlerësim real të këtyre burimeve dhe rezervave që ato kanë në kushtet kur shpesh po përballemi me dukurive tepër shqetësuese për shkak të ndryshimeve klimatike të shoqëruara dhe nga ndryshime demografike. Ky vlerësim ka si synim evidentimin e këtyre rezervave ujore në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën 11, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe kapacitetet e burimeve ujore për të cilat ende nuk kemi pasi një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 10. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë deh Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Durrës	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(I/ditë, banor)				(I/ditë, banor)
Viti 2025	506,727	52,592,000	57.9	577,663	39,068,500	+ 185.3	+ 127.4

**Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.*

Nga tabela nr. 11 shihet se shoqëria rajonale UK Durrës ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Durrës

Shoqëria Rajonale UK Durrës, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Kavajë, Krujë dhe Rrogozhinë, ka nën juridiksion 577,663 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 506,727 banorë ose 87.7% të popullsisë totale nga 85.5 % që rezultonte në vitin 2024. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 140,497 lidhje nga 136,114 lidhje në vitin 2024, nga të cilat 133,823 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës me një rritje prej 5,406 lidhje më shumë për këtë vit.

Prodhimi vjetor 52,592,000 m³ megjithëse i rritur me 580,000 m³ nga viti 2024, rezulton se matet, nga 74.3% në vitin 2024 në nivelin 40.3 %, që sipas informacioneve pranë shoqërisë vijnë si rezultat i problematikave që u hasën në sistemin SCADA gjatë muajve të parë të vitit 2025. Nevoja për aparate ujëmatës në pikat prodhuese dhe një menaxhim teknik më i mirë i sistemeve të kontrollit është imediate .

Uji Pa të Ardhura rezulton i përkeqësuar në vlerat 68.35% të ujit që hyn në sistem nga 67,32 % që rezultonte në vitin 2024. Gjithashtu rezulton se edhe niveli total i faturimit në 31.65% tregon për një përkeqësim të nivelit të të ardhurave për shoqërinë, nga 32,68 % të prodhimit që ishte në vitin 2024.

Tabela nr. 12, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2024, për Sh. Rajonale UK Durrës.

Tabela nr. 11. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Durrës - Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar i matur	21,204,567	40.32%
Volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar	31,387,433	59.68%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	52,592,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	15,536,886	29.54%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,110,910	2.11%
Faturimi total	16,647,796	31.65%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	7,341,459	13.96%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,525,917	8.61%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	3,026,049	5.75%
Humbjet e dukshme (administrative)	14,893,425	28.32%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	2,631,347	5.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	526,269	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	526,269	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	16,314,353	31.02%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	1,052,539	2.00%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	21,050,778	40.03%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	35,944,203	68.35%
UJI PA TË ARDHURA	35,944,203	68.35%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 12:

- Për vitin 2025 treguesi UPA është në nivelin 68.35 % nga 67.32 % që ishte në vitin 2024 të prodhimit vjetor, me një përkeqësim me 1.03 % duke pasqyruar nivel mjaft të pakënaqshëm dhe kërkon angazhim serioz pasi rrezikon qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.

- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar” në nivelin 40.3% nga 74.3% në vitin 2024 si dhe konsumi i matur nga faturimi total rezulton 93.3% nga 91.48 %, por duke mos arritur nivelin e faturimit të parashikuar në buxhet siç dhe informon shoqëria, tregon se nga ana e shoqërisë kërkohet impenjim dhe planifikim i fondeve deri sa të arrihet matja dhe faturimi 100% i ujit që hyn në sistemin e ujësjellësit.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit në nivelin 13.96% nga 16.78% në vitin 2024, dhe atë të shpërndarjes prej 8.61% nga 8 % në vitin 2024 janë në nivele të larta dhe megjithëse me një trend pozitiv krahasuar me dy vitet e mëparshme kërkojnë ndërhyrje urgjente nëpërmjet taks-forcës për përmirësim për të pasur shërbim cilësor të furnizimit me ujë.
- Humbjet teknike 40.03 % nga 37.19 % në vitin 2024 konsiderohen të larta dhe në nivele të papranueshme, dhe shkaktohen kryesisht nga humbjet në rrjetin e shpërndarjes në nivelin 31.02 % i cili rezulton i përkeqësuar krahasuar me nivelin 28.83 % në vitin 2024 dhe të transmetimit në nivelin 5 % nga 4.65 %. Shoqëria duhet të marrë masat e duhura që të mos përsëriten problematikat e sistemit SCADA, të bëjë analizën e duhur për të gjetur arsyet dhe zgjidhjet e duhura për reduktimin e tyre.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve kryhet pjesërisht me zona të ndara me matje (DMA) dhe në përgjithësi hasen vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit nga të gjitha njësitë që përbëjnë shoqërinë rajonale. Trajnimi i stafit është i domosdoshëm për me tepër për ish shoqëritë UK Krujë, Kavajë dhe Rrogozhinë.

Nga analiza e bilancit të ujit vihet re se në këtë shoqëri rajonale komponenti që zë peshën më të madhe të humbjeve janë humbjet në rrjetin e shpërndarjes (31.02 %), humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit (13.96 %) dhe atë të shpërndarjes prej (8,61 %), si dhe humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj. me (5.75 %) apo humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit (5 %). Kjo situatë nxjerrë në pah nevojën për investime dhe mbi të gjitha një menaxhim dhe ndërhyrje urgjente nëpërmjet taks-forcës për përmirësim të humbjeve nga lidhjet e paligjshme, marrjen e masave për një monitorim të vazhdueshëm nëpërmjet sistemit SCADA dhe evitimin e mosfunksionimit të tij, për të pasur shërbim cilësor të furnizimit me ujë.

Rekomandime:

- *Të sigurohen fonde nga programet qeveritare, donatorët dhe burimet e brendshme të shoqërisë për instalimin e ujëmatësve në prodhim, rezervuarë dhe zona DMA, me qëllim hartimin e një bilanci sa më të saktë të ujit dhe identifikimin e humbjeve reale dhe administrative.*

- *Të vazhdojë me konsistencë projektimi dhe realizimi i DMA-ve funksionale në të gjithë zonën e shërbimit, të integruara me sistemin SCADA, në mënyrë që të mundësohet monitorim i vazhdueshëm i prurjeve, presioneve dhe konsumit në çdo zonë të rrjetit.*
- *Të realizohet auditim teknik i plotë i sistemit ekzistues SCADA për identifikimin e pajisjeve jashtë funksionit, problemeve të komunikimit, mungesës së sensorëve dhe dobësive në sigurinë kibernetike, si dhe të merren masa për rikthimin e funksionalitetit të plotë të sistemit.*
- *Të trajnohet vazhdimisht stafi teknik dhe IT për përdorimin, mirëmbajtjen dhe analizimin e të dhënave të SCADA, si dhe për menaxhimin e humbjeve të ujit sipas standardeve kombëtare dhe praktikave moderne të sektorit.*
- *Struktura përgjegjëse për monitorimin e performancës së rrjetit dhe përpunimin e të dhënave operative, raportimi periodik mbi humbjet e ujit, efikasiteti energjetik dhe funksionimi i sistemit SCADA, duhet të jetë sa më eficiente dhe efikase dhe të përgatisë raporte periodike për të mbështetur vendimmarrjen dhe planifikimin e investimeve prioritare për vitet në vijim.*
- *Të rritet përqindja e konsumatorëve familjarë dhe bizneseve me matje individuale funksionale, duke synuar afim gradual me nivelin 100% të matjes, si bazë për uljen e humbjeve administrative dhe përmirësimin e faturimit.*
- *Në lidhje me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme në rrjetin e transmetimit prej 13.96 %, shoqëria duhet të ndërmarrë plan veprimi në bashkëpunim me Task Forcën e shoqërisë, me verifikime në vend për shkëputjen e tyre, apo anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar.*
- *Për humbjet reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivel shume të lartë prej 31%, duhet të evidentohen nëse janë probleme të gjendjes teknike jo të mirë të rrjetit dhe të planifikohen fonde nga shoqëria për rehabilitimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktimin e treguesit të Ujit Pa të Ardhura.*
- *Bashkëpunim sa më koherent dhe efektiv i strukturës së ngritur pranë kësaj shoqërie, për menaxhimin e UPA, me institucionin e ERRU-së për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e një bilancit të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

6. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

Shoqëria Rajonale UK Elbasan është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Elbasan, UK Librazhd, UK Gramsh, UK Cërrik, UK Belsh dhe UK Peqin. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan, paraqiten në Tabelën nr. 13. Analiza e të dhënave të Tabelës nr. 13, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 71.5 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 78.6 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 12. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Elbasan	Popullsia me shërbim	konsumi total ne m ³	Konsumi I matur në m ³	Konsumi I pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	262,622	6,919,000	6,224,000	695,000	57,530	5,844	71.5	78.6	72.2

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën nr. 14 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 13. Konsumi i Faturuar për konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Elbasan	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	262,622	21,858,000	72.2	419,310	62,692,462	+ 409.6	+ 337.4

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Bazuar në të dhënat e Tabelës 14, konstatohet se Shoqëria Rajonale UK Elbasan disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitet përbërëse. Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan

Shoqëria Rajonale UK Elbasan e krijuar si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Elbasan, Belsh, Cërrik, Gramsh, Peqin dhe Librazhd, ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 256,257 banorë, duke mbuluar rreth 62.6% të popullsisë në zonën e saj të shërbimit. Numri total i lidhjeve të furnizimit me ujë rezulton 69,936 lidhje, nga të cilat 63,947 janë të pajisura me aparate ujëmatëse, duke përfaqësuar 91.44% të totalit të lidhjeve. Ky tregues paraqet përmirësim krahasuar me vitin 2024, kur niveli i pajisjes me ujëmatës ishte 90.6%.

Për vitin 2025, sasia e ujit të prodhuar dhe e futur në sistem llogaritet në 21,858,000 m³. Nga kjo sasi, 88.89% rezulton e matur, ndërsa pjesa e mbetur vlerësohet. Kjo ndikon në saktësinë e përcaktimit të volumit të ujit të prodhuar dhe, njëkohësisht, rrit besueshmërinë e treguesit UPA. Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) për vitin 2025 rezulton në nivelin 63.52%, krahasuar me 62.45% në vitin 2024, duke reflektuar një përkeqësim prej 1.07 %. Shoqëria faturon 7,974,000 m³ ujë, që përfaqëson 36.48% të sasisë totale të ujit të futur në sistem.

Tabela nr. 15, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Elbasan.

Tabela nr. 14. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Elbasan - Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem I matur	19,430,340	88.89%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem I vlerësuar	2,427,660	11.11%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	21,858,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	7,273,000	33.27%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	701,000	3.21%
Faturimi total	7,974,000	36.48%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	1,000,100	4.58%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	502,160	2.30%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	2,783,720	12.74%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	3,608,700	16.51%
Humbjet e dukshme (administrative)	6,894,580	31.54%

Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	1,204,200	5.51%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	438,920	2.01%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	775,600	3.55%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	2,140,300	9.79%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	1,430,300	6.54%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	5,989,320	27.40%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	12,883,900	58.94%
UJI PA TË ARDHURA	13,884,000	63.52%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 15 :

- Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA), në nivelin 63.52% të prodhimit vjetor, paraqet një përkeqësim krahasuar me vitin 2024 dhe vazhdon të mbetet në nivele shumë të larta, duke kërkuar ndërhyrje prioritare për përmirësimin e performancës së sistemit.
- Sasia e “Ujit të Prodhuar” e matur përfaqëson 88.89% të totalit të ujit që hyn në sistem, ndërsa pjesa e mbetur bazohet në vlerësime. Niveli i matjes kontribuon në saktësinë e përcaktimit të volumit të ujit të prodhuar dhe, njëkohësisht, rrit besueshmërinë e treguesit UPA. Matja e plotë dhe e saktë e ujit të prodhuar është thelbësore për një faturim korrekt, përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, si dhe për nxitjen e përdorimit racional të burimeve ujore dhe reduktimin e konsumit të panevojshëm.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës rezultojnë në nivelin 12.74%, duke shënuar rritje krahasuar me 11.24% në vitin 2024 dhe duke reflektuar një tendencë përkeqësimi të këtij treguesi.
- Nga humbjet totale prej 58.94%, humbjet e dukshme (administrative) përbëjnë 31.54%, nivel i konsiderueshëm që kërkon analizë më të detajuar dhe argumentim teknik për identifikimin e shkaqeve dhe përcaktimin e masave korrigjuese. Ndërkohë, humbjet reale (teknike) përbëjnë 27.40% të totalit të humbjeve.
- Në kategorinë e humbjeve të dukshme, peshën më të madhe e zënë humbjet e ujit të shkaktuara nga pasaktësitë në matje, nën faturimi dhe faktorë të ngjashëm, të cilat arrijnë në 16.51%, kundrejt 15.61% në vitin 2024, duke treguar një trend negativ në rritje. Gjithashtu, humbjet për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës, në nivelin 12.74%, mbeten në nivele të larta dhe të papranueshme.
- Për sa i përket humbjeve reale, komponenti kryesor mbetet humbja e ujit nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes, e cila rezulton në nivelin 9.79%, krahasuar me 11.24% në vitin 2024, duke rezultuar me

përmirësim. Ndërkohë, humbjet e lidhura me riparimet në linjat e ujësjellësit mbeten pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës.

- Konsumi i autorizuar i pa faturuar rezulton në nivelin 4.58%, nga 5.56% në vitin 2024. Megjithëse ka shënuar ulje, ai vazhdon të ndikojë në nivelin e UPA-së dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm.
- Procesi i vlerësimit dhe analizës së humbjeve nuk realizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar përmes zonave të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.
- Në përgjithësi, shoqëria përballlet me vështirësi të konsiderueshme në monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë territorin e shërbimit, çka kufizon mundësinë për identifikimin e saktë të problematikave dhe ndërmarrjen e masave efektive për reduktimin e tyre.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të angazhohet maksimalisht në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit teknik përmes pjesëmarrjes në programet kombëtare mbi menaxhimin e humbjeve të ujit. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet punonjësve përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe saktësisë së informacionit të përdorur në hartimin e bilancit të ujit për të gjithë zonën e shërbimit.*
- *Shoqëria duhet të vazhdojë investimet për zgjerimin dhe modernizimin e sistemit të matjes, duke përfshirë jo vetëm matësit në pikat e prodhimit, por edhe matësit në rrjetin e shpërndarjes. Kjo do të mundësojë një matje më të saktë të ujit të prodhuar dhe të faturuar, si dhe hartimin e një bilanci uji më të besueshëm dhe më pranë realitetit operacional.*
- *Rekomandohet sigurimi i fondeve të nevojshme për instalimin e ujëmatësve tek konsumatorët familjarë, me synimin që niveli i matjes të afrohet sa më shumë me 100%. Prioritet duhet t'i jepet vendosjes së ujëmatësve inteligjentë, të cilët mundësojnë menaxhim më efikas të konsumit, rritje të saktësisë së faturimit dhe reduktim të humbjeve që lidhen me pasaktësitë në matje dhe nën faturim. Fokus i veçantë duhet të vendoset në zonat rurale dhe në banesat individuale.*
- *Niveli i lartë i lidhjeve të paligjshme kërkon hartimin dhe zbatimin e një plani të strukturuar veprimi për identifikimin dhe formalizimin e bazës së klientëve. Në bashkëpunim me Task-Forcën dhe njësitë e qeverisjes vendore, duhet të kryhen kontrole dhe verifikime në terren për evidentimin e anashkalimeve të ujëmatësve, lidhjeve dytësore, klientëve të paregjistruar, si dhe për kontrollin e procesit të leximit të matësve. Këto masa do të kontribuojnë në reduktimin e ujit të pa faturuar dhe përmirësimin e administrimit të rrjetit.*

- *Për lidhjet që nuk janë të pajisura me ujëmatës dhe në rastet kur instalimi i tyre nuk është i mundur, rekomandohet verifikimi i numrit të banorëve përmes dokumentacionit përkatës administrativ dhe faturimi sipas kuadrit ligjor në fuqi. Gjithashtu, është e nevojshme përditësimi i të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe territorin e juridiksionit, në përputhje me statistikën zyrtare të INSTAT, për të siguruar analiza më të sakta mbi konsumin dhe përdorimin e ujit.*
- *Shoqëria duhet të intensifikojë bashkëpunimin me ERRU-në për adresimin e vështirësive që lidhen me hartimin e bilancit të ujit dhe raportimin e tij brenda afateve të përcaktuara. Bilanci i ujit duhet të përgatitet dhe të dorëzohet në kohë, në fillim të çdo viti, duke garantuar përmbushjen e kërkesave rregullatore dhe përmirësimin e procesit të monitorimit të performancës.*

7. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a

Shoqëria rajonale UK Fier sh.a. është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK ose Njësitë, përkatësisht UK Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Fier sh.a jepen në tabelën nr. 16.

Nga të dhënat e Tabelës nr.16, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 63.4 l/ditë për banorë, dhe faturimi aforfe që rezultojnë një konsum prej 94.6 l/ditë për banorë. Në të dy rastet, niveli i konsumit mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacionalë.

Në veçanti, vlerësimi i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 15. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Fier	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banorë	l/ditë, banorë	l/ditë, banorë
Viti 2025	202,120	5,100,060	3,822,000	1,278,000	41,272	9,258	63.4	94.6	69.1

Menaxhimi sa me efektiv i burimeve të ujit për konsum publik dhe nga ana tjetër tendenca në rritje të vazhdueshme e kërkesës për ujë, kërkojnë një vlerësim real të këtyre burimeve dhe rezervave që ato kanë në kushtet kur shpesh po përballemi me dukurive tepër shqetësuese për shkak të ndryshimeve klimatike të shoqëruara dhe nga ndryshime demografike. Ky vlerësim ka si synim evidentimin e këtyre rezervave ujore në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën nr. 17, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre për të cilat ende nuk kemi një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 16. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Fier	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)				(l/ditë, banor)
Viti 2025	202,120	15,804,410	69.1	323,451	48,053,000	+ 407.0	+ 337.9

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Nga tabela nr. 17 shihet se shoqëria rajonale UK Fier ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Fier

Shoqëria Rajonale UK Fier, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Fier, Patos, Roskovec dhe Mallakastër, ka nën juridiksion sipas raportimeve të vet shoqërisë, 323,451 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 202,120 banorë ose 62.48 % nga 61.88 % në vitin 2024 të popullsisë totale.

Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 55,354 lidhje në total, nga të cilat 50,530 janë lidhje familjare. Nga informacioni në sektorin e monitorimit rezultojnë në total me matje janë 45,549 lidhje ose 82.3% nga 80.44 % që rezultonte në vitin 2024.

Prodhimi vjetor rezulton në masën 15,804,410 m³ dhe shoqëria vazhdon të raportojë se është i matur në nivelin 100 %, çka tregon se për të gjitha burimet e shfrytëzueshme ka aparate ujëmatës në pikat prodhuese.

“Uji Pa të Ardatura” rezultoi në nivelin 62.28% të ujit që hyn në sistem nga 61.47 %, duke pasqyruar një trend përkeqësimi krahasuar me vitin 2024. Shoqëria faturon vetëm 5,961,610 m³ të sasisë së ujit të prodhuar ose 37.72% nga 38.53 % që rezultonte në vitin 2024.

Tabela 18, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Fier sh.a.

Tabela nr. 17. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Fier sh.a. - Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	15,804,410	100 %
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	-	-
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	15,804,410	100%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,636,490	29.34%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,325,120	8.38%
Faturimi total	5,961,610	37.72%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	310,000	1.96%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	1,580,000	10.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,025,751	25.47%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	1,350,049	8.54%
Humbjet e dukshme (administrative)	6,955,800	44.01%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	190,000	1.20%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	130,000	0.82%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	180,000	1.14%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	1,750,000	11.07%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	327,000	2.07%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	2,577,000	16.31%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	9,532,800	60.32%
UJI PA TË ARDHURA	9,842,800	62.28%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 18:

- Treguesi UPA në nivelin e 62.28% të prodhimit vjetor për vitin 2025, konsiderohet shumë i lartë sidomos dhe kur vërehet një trend jo pozitiv krahasuar me vitin 2024 që ishte në nivelin 61.47%.

- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e shpërndarjes (25.47 %) dhe të transmetimit (10 %) janë në nivele shumë të larta dhe në të njëjtat nivele krahasuar me vitin 2024 dhe që duhen verifikuar në terren për nivelin real të tyre.
- Në humbjet teknike, humbjet nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes (11.07 % të prodhimit vjetor) konsiderohen mjaft të larta, dhe pothuaj të pandryshuara krahasuar me vitin 2024, ndaj shoqëria duhen të japë patjetër argumente bindëse për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 91.3% të numrit total të konsumatorëve nga 73.44 % në vitin 2024, që tregon se shoqëria ka kapacitete që të arrijë sa më afër nivelit 100% të matjes, duke bërë të mundur një menaxhim më të mirë të kërkesës për ujë.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë përveç qytetit të Fierit ku ekzistojnë ndarjet sipas DMA, si dhe vërehen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit, nga të gjitha njësitë që përbëjnë këtë shoqëri rajonale.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të vazhdojë përpjekjet për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë për të mundësuar një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit nga stafi përgjegjës i shoqërisë.*
- *Shoqëria duhet të investojë realisht në burimet njerëzore përgjegjëse për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA ekzistuese si dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale. Gjithashtu të insistohet që Bilanci i Ujit të trajtohet jo thjesht si një statikë por si analizë reale që evidenton gjithë problematikën që shoqëria ka lidhur me sistemet e ujësjellësit.*
- *Shoqëria duhet sigurojë identifikimin e çdo lidhje të paligjshme si në rrjetin shpërndarës ashtu dhe në rrjetin e transmetimit, nëpërmjet Taks-Forcës në bashkëpunim me degën e shitjes duke ndërmarrë veprime konkrete, të përcaktojë sa më saktë bazën e klientëve, si dhe nëpërmjet verifikimeve në vend të identifikojnë për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Shoqëria duhet të gjejë fonde për të rritur përqindjen jo vetëm të konsumatorëve familjare me matës por të gjithë kategoritë e klientëve të saj që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*

- Për çdo lidhje pa matës, deri në vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.
- Problematika në disa raste nuk është e njëjtë për çdo njësi. Ndaj nevojitet një analizë për secilën njësi dhe më pas një vlerësim i konsoliduar në nivel rajonal, duke pasur kështu dhe një guidë në procesin e evidentimit të nivelit të humbjeve në të gjithë zonën e juridiksionit të saj.
- Bashkëpunimi sa më koherent dhe efektiv i shoqërisë me institucionin e ERRU-së, për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit të saktë dhe real, si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.

8. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë

Shoqëria Rajonale UK Gjirokastrë është krijuar si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive dhe njësive të ujësjellës-kanalizimeve të Gjirokastrës, Tepelenës, Këlcyrës, Përmetit, Libohovës, Dropullit dhe Memaliajt. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UK Gjirokastrë, paraqiten në Tabelën nr. 19.

Analiza e të dhënave të Tabelës nr. 19, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 70.2 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 92 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 18. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Gjirokastrë	Popullsia me shërbim	konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	114,332	3,155,310	2,208,250	947,060	21,521	7,048	70.2	92.0	75.6

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën 20 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 19. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Gjirokastër	Popullsia e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	114,332	6,168,000	75.6	145,355	44,136,000	+ 831.9	+ 756.3

**Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU*

Bazuar në të dhënat e Tabelës nr. 20, konstatohet se Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitë përbërëse. Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastër sh.a.

Shoqëria Rajonale UK Gjirokastër është krijuar si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Përmet, Libohovë, Dropull dhe UK Memaliaj. Numri total i lidhjeve të furnizimit me ujë është 31,498, nga të cilat 24,378 lidhje, ose 77.39%, janë të pajisura me aparate ujëmatëse. Prodhimi vjetor i ujit rezulton 6,168,000 m³, ndërsa niveli i matjes së ujit të prodhuar është 60.78%. Nisur nga ky tregues, pajisja me ujëmatës në pikat e prodhimit për të gjitha burimet e shfrytëzueshme paraqitet si një nevojë urgjente dhe prioritet.

Uji Pa të Ardhura (UPA) rezulton në nivelin 40.92% të ujit të futur në sistem, krahasuar me 35.57% të raportuar në vitin 2024. Shoqëria faturon 3,644,160 m³, ose 59.08% të prodhimit total, ndërsa në vitin 2024 janë faturuar 4,112,000 m³, ose 64.43% e prodhimit.

Tabela nr. 21, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Gjirokastrë.

Tabela nr. 20. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Gjirokastrë – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	3,749,000	60.78%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	2,419,000	39.22%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,168,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,656,850	43.07%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	987,310	16.01%
Faturimi total	3,644,160	59.08%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	46,000	0.75%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	-	0.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	450,312	7.30%
Humbjet e dukshme (administrative)	450,312	7.30%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	450,633	7.31%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	163,837	2.66%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	410,174	6.65%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	584,381	9.47%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	418,503	6.79%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	2,027,528	32.87%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,477,840	40.17%
UJI PA TË ARDHURA	2,523,840	40.92%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 21:

- Treguesi i UPA-së në nivelin 40.92% paraqet një përkeqësim krahasuar me vitin 2024, kur rezultonte 35.57%. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme dhe masa konkrete për reduktimin e humbjeve në të gjithë zonën e shërbimit, me qëllim përmirësimin e këtij treguesi.
- Treguesi “Uji i Prodhuar i Matur” rezulton në nivelin 60.78%, me një rritje prej 9.62 % krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, niveli i matjes mbetet ende i ulët, duke ndikuar në besueshmërinë e të dhënave dhe të vlerave absolute të volumeve të ujit që përbëjnë komponentët e bilancit të ujit.
- Humbjet administrative rezultojnë nga nën faturimi dhe pasaktësitë në leximin e ujëmatësve. Këto humbje raportohen në nivelin 7.3%, me rritje krahasuar me vitin 2024. Ndërkohë, humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes raportohen në nivel zero për disa vite radhazi. Ky raportim kërkon verifikim të mëtejshëm, pasi shtrirja e gjerë territoriale e zonës së shërbimit e bën të vështirë supozimin se nuk ekzistojnë lidhje të paligjshme.

- Humbjet teknike, të vlerësuara në nivelin 32.87%, konsiderohen të larta dhe kanë mbetur në nivele të njëjta për disa vite radhazi. Për këtë arsye, nevojitet analizë më e detajuar dhe argumentim teknik për identifikimin e shkaqeve dhe përcaktimin e masave për reduktimin e tyre.
- Konsumatorët familjarë të pajisur me matës përbëjnë rreth 68% të numrit total të konsumatorëve. Për një menaxhim më efikas të kërkesës për ujë dhe përmirësimin e saktësisë së faturimit, ky tregues duhet të afrohet sa më shumë me nivelin 100%.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk realizohen në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk mbështeten në zona të ndara matjeje (DMA) në të gjithë territorin e shërbimit të shoqërisë, me përjashtim të qytetit të Gjirokastrës. Zgjerimi i sistemit DMA në të gjithë zonën e shërbimit do të mundësonte monitorim më të saktë të humbjeve dhe menaxhim më efektiv të rrjetit të furnizimit me ujë.

Rekomandime:

- *Investimi në ujëmatës për pikat e prodhimit paraqitet si një nevojë urgjente dhe prioritare, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e burimeve të furnizimit me ujë ende nuk janë të pajisura me pajisje matëse. Shoqëria duhet të ndërmarrë masa të menjëhershme për sigurimin e fondeve, qoftë nga buxheti qendror apo nga burimet e brendshme, me qëllim instalimin e tyre dhe hartimin e një bilanci uji sa më të saktë, i cili do të mundësojë përcaktimin real të nivelit të UPA-së.*
- *Të sigurohen fondet e nevojshme për projektimin dhe implementimin e sistemeve DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, duke mundësuar monitorimin, diagnostikimin dhe marrjen e masave për reduktimin e humbjeve në sistemin e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci të saktë të ujit.*
- *Të vijojë trajnimi i stafit teknik në programet kombëtare për menaxhimin e humbjeve të ujit, të organizuara nga SHUKALB dhe institucione të tjera përkatëse. Gjithashtu, të caktohet një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara, si dhe për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.*
- *Të sigurohen fonde për rritjen e përqindjes së konsumatorëve familjarë të pajisur me matës, me synim afrimin e këtij treguesi sa më pranë nivelit 100%, duke mundësuar një menaxhim më efikas të kërkesës për ujë dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, të cilat në disa raste raportohen në nivele të ulëta dhe jo plotësisht të besueshme.*
- *Të hartohet dhe zbatohet një plan veprimi me prioritet të qarta për instalimin e matësve në banesat private, veçanërisht në zonat rurale.*

- *Të ngrihet një grup pune në bashkëpunim me sektorin e shitjes, i cili të kryejë verifikime periodike në terren për klientët e regjistruar me kontratë me shoqërinë, duke kontrolluar funksionimin e matësve dhe duke evidentuar rastet e ujit të pafaturuar.*
- *Të krijohen dhe mirëmbahen sisteme të integruara informacioni që garantojnë raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave, në funksion të hartimit të bilancit të ujit dhe kërkesave të tjera raportuese.*
- *Të planifikohen investime për pajisjen me ujëmatës të të gjitha kategorive të konsumatorëve, me qëllim që çdo lidhje e faturuar të mbështetet në konsum real të matur.*
- *Për lidhjet pa matës, në rastet kur instalimi i tyre nuk është i mundur, faturimi duhet të bazohet në verifikimin e numrit të banorëve (përmes certifikatës familjare të përditësuar) dhe të zbatohet në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992.*
- *Duke qenë se problematikat ndryshojnë nga një njësi në tjetrën, analizimi dhe adresimi i tyre duhet të realizohet në mënyrë të veçantë për secilën njësi, në kuadër të bilancit përkatës të ujit.*
- *Të forcohet bashkëpunimi me ERRU për tejkalimin e vështirësive në hartimin e bilancit të ujit dhe për dorëzimin në afat të këtij dokumenti. Bilanci i ujit duhet të përgatitet dhe dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Gjithashtu, të caktohet një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe verifikimin e saktësisë së të dhënave të raportuara.*

9. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Korçë sh.a

Shoqëria Rajonale UK Korçë është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Korçë, Devoll, Maliq, Pustec dhe Kolonjë. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UK Korçë, paraqiten në Tabelën nr. 22. Analiza e të dhënave të Tabelës nr. 22, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 57.1 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 18.6 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit sipas faturimit aforfe.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë

16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 21. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Korçë	Popullsia me shërbim	Konsumi total ne m3	Konsumi I matur ne m3	Konsumi I pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							I/ditë, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
Viti 2025	223,859	4,540,231	4,478,723	61,508	50,970	1,205	57.1	18.6	55.6

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën nr. 23 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 22. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Korçë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(I/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(I/ditë, banor)	(I/ditë, banor)
Viti 2025	223,859	7,881,230	55.6	226,121	23,235,528	+ 281.5	+ 225.9

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Bazuar në të dhënat e Tabelës nr. 23, konstatohet se Shoqëria Rajonale UK Korçë disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitet përbërëse. Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për ish Shoqërinë Rajonale UK Korçë sh.a

Referuar të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit teknik dhe të verifikuara pranë sektorit të monitorimit rezulton se, prodhimi vjetor prej 7,881,230 m³ rezulton i matur në nivelin 88 %. Shoqëria faturon vetëm 5,222,196 m³ ujë ose 66.26 % duke rezultuar pothuaj në të njëjtat nivele si në vitin 2024. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit më ujë raportohet 56,369 lidhje, nga të cilat 97 % janë të pajisur me aparate ujëmatës. Nevoja e aparateve ujëmatës në pikat prodhuese është e domosdoshme për të gjitha burimet e shfrytëzueshme.

“UPA” rezulton në nivelin 33.74 % duke ruajtur pothuaj të njëjtin nivel me vitin 2024. Ky rezultat pasqyron se kjo shoqëri ka një nivel të mirë krahasuar me shoqëritë e tjera dhe afër mesatares kombëtare dhe vazhdon ta rendisë këtë shoqëri ndër kompanitë më të mira në shkallë kombëtare. Në qytetin e Korçës, krahas matësve që ndodhen në puse, në stacionin e pompave dhe në depo, ka dhe 7 matësa zonal të cilët ndodhen në rrjetin e qytetit. Këto DMA (zona të matura) janë krijuar për ato pjesë të rrjetit të cilat janë të hapura, pra jo unazore dhe kanë hyrje uji vetëm në një pikë. Pjesa tjetër e rajonit nuk ka DMA, por ka matje në dalje nga pusët, depot dhe stacionet për secilën qendër të banuar. Kjo ndodh për arsye se rrjetet e tjera, përjashtuar Korçën kanë një gjatësi relativisht të vogël dhe janë të kontrollueshme edhe me një matës.

Në tabelën nr. 24, paraqitet bilanci i ujit si dhe komponentët përbërës të tij për ish shoqërinë UK Korçë.

Tabela nr. 23. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Korçë – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	6,921,230	88%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	960,000	12%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	7,881,230	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	5,158,962	65.46%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	63,234	0.80%
Faturimi total	5,222,196	66.26%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	77,132	0.98%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	349,856	4.44%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	243,910	3.09%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	394,061	5.00%
Humbjet e dukshme (administrative)	987,827	12.53%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	788,122	10.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	-	0.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	15,933	0.20%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	790,020	10.02%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	-	0.00%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,594,075	20.23%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,581,902	32.76%
UJI PA TË ARDHURA	2,659,034	33.74%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 24.

- UPA në nivelin 33.74 %, pothuaj i pandryshuar krahasuar me vitin 2024, vlerësohet ende brenda parametrave të kënaqshëm të performancës dhe në përputhje me nivelin mesatar të sektorit në shkallë kombëtare.
- Niveli i matjes për treguesin “Uji i Prodhuar” është rritur në 88%, nga 70.3% në vitin 2024, duke reflektuar një trend të qartë përmirësimi. Kjo rritje kontribuon në saktësinë e përcaktimit të volumit të ujit të prodhuar dhe, njëkohësisht, rrit besueshmërinë e treguesit UPA. Matja e plotë dhe e saktë e ujit të prodhuar është thelbësore për një faturim korrekt, përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj konsumatorëve, si dhe për nxitjen e përdorimit racional të burimeve ujore dhe reduktimin e konsumit të panevojshëm.
- Konsumi total i faturuar nivelin e 66.26 %, ka një luhatje të lehtë me 0.2% nga viti 2024. Nga ky volum, vetëm 0.80 % përbën konsum të faturuar të pamatur, duke treguar përmirësim të mëtejshëm në procesin e matjes dhe faturimit.
- Niveli i humbjeve reale rezulton 20.23 %, kundrejt 22.45 % në vitin 2024. Si gjate vitit 2024 dhe për këtë vit humbjet raportohen nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 10.03 % dhe nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit në nivelin 10.00 % pothuajse të njëjtë me vitin 2024. Ky tregues kërkon monitorim të vazhdueshëm dhe ndërmarrjen e masave për reduktimin e humbjeve në rrjet, me synim rritjen e efikasitetit operacional dhe përmirësimin e performancës së sistemit të furnizimit me ujë.
- Humbjet e dukshme rezultojnë në nivelin 12.53%, ose 987,827 m³, duke shënuar rritje krahasuar me vitin 2024, kur ky tregues rezultonte 11.08%. Nga analiza rezulton se humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit që në vitin 2024 ishin zero, për vitin 2025 raportohen 4.44 % ose 349,856 m³. Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit nën faturim etj. në % janë të njëjtë me 5% por në sasi kanë një përkeqësim nga 384,536 m³ në 394,061 m³ për vitin 2025.
- Numri i klientëve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 56,369 lidhje, nga të cilat 97.86 % janë të pajisur me aparate ujëmatës.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të ndërmarrë masa për hartimin e një bilanci mujor dhe vjetor sa më të saktë të ujit, sipas metodologjisë IWA, duke u bazuar në të dhënat e sistemeve SCADA dhe duke integruar teknologjinë GIS për monitorimin në kohë reale të rrjetit.*

- *Për reduktimin e humbjeve reale, të cilat lidhen kryesisht me rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes dhe atë të transmetimit, rekomandohet identifikimi dhe evidentimi i segmenteve problematike të rrjetit, veçanërisht në zonat rurale ku është konstatuar përkeqësim i situatës gjatë vitit raportues. Prioritet duhet t'i jepet zëvendësimit të tubacioneve bazuar në moshën, materialin përbërës dhe historikun e defekteve, duke siguruar njëkohësisht fondet e nevojshme për rehabilitimin e tyre. Zbatimi i këtyre masave pritet të ndikojë drejtpërdrejt në uljen e UPA-së.*
- *Hartimi dhe zbatimi i një plani veprimi të detajuar për secilën njësi të shërbimit, bazuar në problematikat e evidentuara përgjatë gjithë zinxhirit të furnizimit me ujë, nga prodhimi deri te konsumatori fundor, do të shërbejë si instrument orientues për përmirësimin e performancës dhe reduktimin e humbjeve administrative dhe reale në të gjithë zonën e juridiksionit.*
- *Rekomandohet projektimi dhe implementimi i sistemeve DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, me qëllim evidentimin, monitorimin dhe menaxhimin më efektiv të humbjeve, si dhe hartimin e një bilanci të saktë dhe të besueshëm të ujit.*
- *Duke qenë se niveli i matjes së ujit të prodhuar ka arritur në rreth 90%, shoqëria duhet të sigurojë mirëmbajtjen e vazhdueshme të ujëmatësve në prodhim për të garantuar saktësinë e të dhënave. Gjithashtu, rekomandohet përshpejtimi i procesit të pajisjes së klientëve, veçanërisht familjarë, me ujëmatës inteligjentë dhe të kalibruar, pasi treguesi “Humbjet e ujit nga pasaktësitë në matje dhe nën faturim” ka mbetur i pandryshuar gjatë periudhës 2024–2025.*
- *Shoqëria duhet të hartojë dhe zbatojë plane konkrete për mbrojtjen e burimeve të ujit, si dhe të intensifikojë aktivitetet për edukimin dhe ndërgjegjësimin e publikut mbi përdorimin e qëndrueshëm të burimeve ujore. Gjithashtu, rekomandohet përdorimi i zgjidhjeve teknologjike moderne për raportimin në kohë reale të defekteve dhe rasteve të shpërdorimit të ujit nga klientët.*
- *Për uljen e nivelit të UPA-së, është thelbësore identifikimi i saktë i shkallës së problemit dhe lokalizimi i zonave me humbjet më të larta. Kjo kërkon verifikimin e vazhdueshëm të të dhënave, kryerjen e matjeve periodike dhe hartimin e balanceve të ujit me përgjegjësi dhe saktësi, me qëllim përcaktimin e një niveli bazë të humbjeve që nuk gjenerojnë të ardhura.*
- *Rekomandohet përditësimi dhe saktësimi i të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe territorin nën juridiksion, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me të dhënat zyrtare të INSTAT. Kjo do të mundësojë analiza më të sakta dhe më të besueshme mbi situatën e konsumit dhe përdorimit të ujit.*

10. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale Kukës sh.a

Shoqëria rajonale UK Kukës u krijua nga bashkimi i ish shoqërive UK, përkatësisht UK Kukës, Tropojë dhe Has. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Kukës jepen në tabelën nr. 25.

Nga të dhënat e Tabelës nr.25, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se konsumi mesatar i faturuar për konsumatorët familjarë me matës është 78.5 litra/ditë për banor, ndërsa për konsumatorët që faturohen aforfe ky tregues rezulton 111.6 litra/ditë për banor. Në të dy rastet, niveli i konsumit mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikat e faturimit apo me faktorë të tjerë operacional.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 24. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Kukës	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	49,292	1,675,200	787,800	887,400	6,408	5,075	78.5	111.6	93.1

Nga ana tjetër, referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën Nr.26, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen kapaciteti total i burimeve ujore të disponueshme për rajonin e kësaj shoqërie.

Tabela nr. 25. Konsumi i faturuar për konsumatorët familjare dhe disponibiliteti i burimeve

Sh.R. Kukës	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Juridiksionit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	49,292	3,533,817	93.1	89,523	33,664,016	+ 1030.2	+ 937.1

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU

Nga tabela nr.26 shihet se shoqëria rajonale UK Kukës ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, (megjithëse ende nuk kemi një vlerësim të përditësuar të kapaciteteve të burimeve) gjithsesi në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja dhe shfrytëzimi me efikasitet i burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitet përbërëse, për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7”.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Kukës

Shoqëria Rajonale UK Kukës, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Kukës, Tropojë dhe Has ofron shërbimin e furnizimit me ujë vetëm për 55.06 % të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 12,855 lidhje, nga të cilat 7,516 lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës dhe rezultojnë të jenë shtuar 104 lidhje të reja krahasuar me vitin 2024. Prodhimi vjetor 3,533,817 m³ rezultojnë i matur në nivelin 21.6% pothuaj në të njëjtin nivel krahasuar me vitin 2024, duke evidentuar nevojën imediate për aparate ujëmatës në pikat prodhuese dhe për të gjitha burimet e shfrytëzueshme. Uji Pa të Ardhura rezultojnë në nivelin 43.35% të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 2,001,800 m³ ujë ose 56.65% të prodhimit dhe krahasuar me vitin 2024 këto tregues janë pothuaj të pandryshuar.

Tabela nr. 27, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. R UK Kukës sh.a.

Tabela nr. 26. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Kukës sh.a. – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit që futet në sistem i matur	762,300	21.60%
Volumi i ujit që futet në sistem i vlerësuar	2,771,517	78.40%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	3,533,817	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	959,800	27.16%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,042,000	29.49%
Faturimi total	2,001,800	56.65%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	78,468	2.22%

Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	80,000	2.26%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	60,000	1.70%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	515,002	14.57%
Humbjet e dukshme (administrative)	655,002	18.54%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	119,805	3.39%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	180,000	5.09%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	140,000	3.96%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	150,000	4.24%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	208,742	5.91%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	798,547	22.60%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,453,549	41.13%
UJI PA TË ARDHURA	1,532,017	43.35%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 27:

- Treguesi UPA në nivelin 43.35% të prodhimit vjetor, në nivel pothuaj të pandryshuar krahasuar me vitin 2024, tregon se shoqëria tashme ka kapërcyer nivelin e performancës së dobët. Megjithatë ky nivel mbetet i lartë dhe mbi objektivat e eficiencës operationale të pritshme për sektorin e ujësjellësit.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar”, në nivelin 21.6% pothuajse i pandryshuar (0.4% më pak) krahasuar me vitet e fundit i bën të pa besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit, duke filluar që nga vlera e pasaktësisë në matje megjithëse rezulton me ulje, në nivelin 14.57% nga 15.83% në vitin 2024 të prodhimit vjetor.
- Vazhdon të ketë përmirësim niveli i humbjeve administrative pasi janë ulur në 18.54% nga 19.78% që rezultonin në vitin 2024, ku peshën më të madhe e zënë humbjet nga pasaktësitë në matje gati 78.6% të humbjeve të dukshme, gjë që shton nivelin e pa besueshmërisë së vlerave mbi sasinë e ujit të prodhuar të matur dhe gjithë vlerat e tjera që përbëjnë një bilanc uji.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës (1.7%) dhe të transmetimit (2.26%), të pandryshuara krahasuar me vitin 2024 nuk mund të konsiderohen të besueshme deri sa shoqëria të argumentojë apo cilësojë nëse ato janë verifikuar në terren nëpërmjet një ekipi të ngritur për këtë qëllim.
- Në humbjet teknike, humbjet nga riparimet në linjat e ujësjellësit në vlera prej 5.91% e prodhimit vjetor, megjithëse një trend zbritës të papërfillshëm krahasuar me vitin 2024 (kjo vlerë rezultonte 5.93 %) duhen të shoqërohen me argumenta për justifikimin e tyre. Po kështu përqendrimi i nivelit të humbjeve nga rrjedhjet në linjat e transmetimit në nivelin 3.39% nga 2.84% dhe i humbjeve nga

rrjedhjet në linjat e shpërndarjes në nivel 4.24% nga 3.95% në vitin 2024, konsiderohen të larta dhe jo të pranueshme. Po kështu pothuaj i pandryshuar rezulton dhe niveli i humbjeve nga rrjedhjet dhe derdhjet në depot e ujit krahasuar me vitin 2024.

- Pra vërehet një përkeqësim pra rritje e nivelit të humbjeve teknike (reale) nga 21.75% në vitin 2024 në nivelin 22.6% në vitin 2025.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 49.8 % të numrit total të konsumatorëve, që për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë ky tregues kërkohet të jetë sa me afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.

Rekomandime:

- *Hartimi real i Bilancit të Ujit së pari kërkon të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë.*
- *Niveli i ulët i ujit të prodhuar të matur evidenton marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me ujëmatës të burimeve të shfrytëzueshme prej shoqërisë, të përmirësojë përqindjen e konsumatorëve familjarë me matës, që ky tregues të jetë sa me afër nivelit 100%, me prioritet instalimin e matësve në shtëpitë private dhe kryesisht në zonat rurale, ato të amortizuara dhe instalimi i matësve inteligjent, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Task - Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren për verifikime në vend, për përmirësimin e disiplinës së faturimit, ndjekje më efikase të debitorëve, evidentimin e lidhjeve e paligjshme, për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, për rritjen e mbulimit me matës individualë dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, lidhur me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohet nga stafe teknike të trajnuara në programe kombëtare dhe ndërkombëtare mbi humbjet e ujit.*

- *Bashkëpunim sa më koherent dhe efektiv i shoqërisë me institucionin e ERRU-së, për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

11. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a

Shoqëria Rajonale UK Lezhë sh.a, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lezhë, Mirditë dhe Kurbin ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 55.9% të popullsisë në juridiksion sipas raportimit pranë sektorit të monitorimit. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Lezhë sh.a, jepen në tabelën 28.

Nga të dhënat e Tabelës nr.28, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 61 l/ditë për banorë dhe sasia e faturuar aforfe 70.1 l/ditë për banorë. Në të dy rastet, niveli i konsumit mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë.

Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacionalë.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 27. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. Lezhe	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi I matur në m ³	Konsumi I pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	118,859	2,707,000	2,242,000	465,000	26,904	3,012	61.0	70.1	62.4

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave

në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 29, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre.

Tabela nr. 28. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Lezhë	Popullsia e Shërbyer *	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	118,859	7,155,545	62.4	212,509	25,383,740	+ 327.3	+ 264.9

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Nga Tabela nr. 29, shihet qartë se shoqëria rajonale UK Lezhë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, por vlen të theksohet se rezultoni në nivele shumë të ulëta konsumi total dhe kjo sjell një vlerësim joreal të sasisë së disponueshme të ujit për banor në ditë, ndërkohë që edhe kapaciteti i burimeve është marrë i pandryshuar, ndaj shoqëria duhet të analizojë dhe të raportojë ecurinë e kapaciteteve të burimeve aktuale. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në kërkesën për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë

Shoqëria Rajonale UK Lezhë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lezhë, Mirditë dhe Kurbin ka nën juridiksion 212,509 banorë sipas të dhënave të raportuara. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë për vitin 2025 është 32 661 lidhje, nga të cilat 29 553 lidhje janë të pajisur me ujëmatës. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 118,859 banorë ose 55.9 % të popullsisë totale.

Prodhimi vjetor prej 7,155,545 m³ rezultoni i matur në nivelin 70% dhe 30% i vlerësuar. Vihet re një rënie e sasisë së ujit të prodhuar krahasuar me 2024 me 906,455 m³, kjo si rezultat i investimeve për Ujëmatëse në pikat prodhuese (burime), kryesisht për njësitë Mirditë dhe Kurbin.

Uji Pa të Ardhura në nivelin 53.94% të ujit që hyn në sistem nga 58.63% raportuar në vitin 2024, tregon për një përmirësim të këtij treguesi. Po kështu dhe faturimi total u realizua në masën e 46.06% të prodhimit nga 41.37 % raportuar në vitin 2024.

Tabela nr. 30, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Lezhë.

Tabela nr. 29. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë sh.a. – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	5,008,881	70
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i pamatur	2,146,664	30
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem total	7,155,545	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,761,300	38.59%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	534,700	7.47%
Faturimi total	3,296,000	46.06%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	5,689	0.08%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit		0.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës		0.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	3,306	0.05%
Humbjet e dukshme (administrative)	3,306	0.05%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	78,527	1.10%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	3,207	0.04%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	3,106	0.04%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	3,736,213	52.21%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjesit	32,704	0.46%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	3,850,550	53.81%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	3,853,856	53.86%
UJI PA TË ARDHURA	3,859,545	53.94%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 30:

- Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 53.94% të ujit që hyn në sistem nga 58.63% raportuar në vitin 2024 duke reflektuar kështu një trend përmirësimi të këtij treguesi të rëndësishëm por ende larg nivelit të performancës së mirë dhe që duhet përmirësuar.
- Niveli i matjes 70% për faktorin “Uji i prodhuar” nga 63.1 % në vitin 2024, shpreh një trend përmirësimi por ende nevojitet marrja e masave për pajisjen me matësa në prodhim aty ku mungojnë.
- Shoqëria duhet të japë sqarime dhe shpjegimet e nevojshme nëse këto parametra vijnë si rezultat i investimeve, matjeve reale dhe kontrolleve e menaxhimit më të mirë, apo si saktësim i vlerave.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes shoqëria vazhdon t'i deklarojë të zeruara, por nuk konsiderohen të besueshme dhe duhet të verifikohen në terren nëpërmjet strukturave të ngritura për këtë qëllim.
- Peshën pothuaj të 99% të humbjeve totale e zënë Humbjet teknike, të cilat janë në nivelin 53.81% nga 57.05% në vitin 2024 të prodhimit vjetor. Këto humbje sipas të dhënave të raportuara nga

shoqëria dominohen nga humbjet për shkak të rrjedhjeve në rrjetin shpërndarës dhe konsiderohen të larta dhe patjetër që kërkojnë argumenta nga ana e shoqërisë për justifikimin e tyre.

- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 82.3% të numrit total të konsumatorëve nga 77.6 % që rezultonte në vitin 2024, por për një menaxhim korrekt të kërkesës për ujë kërkohet të jetë sa me afër nivelit 100% të matjes.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) konkretisht në njësitë Mirditë dhe Kurbin.

Pra nga analiza e bilancit të ujit vihet re se në këtë shoqëri rajonale komponenti pothuaj i vetëm i humbjeve janë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës, që mund të vij nga rrjetet e amortizuara në zonat kryesisht jo urbane duke nxjerrë në pah dhe nevojën për investime. Ajo që është më e evidente janë pothuaj niveli 0 % i humbjeve administrative dhe këtu vazhdojnë të theksojmë se duhet të kihet në vëmendje saktësia e të dhënave të raportuara.

Rekomandime:

- *Të hartohet dhe zbatohet një program i posaçëm për reduktimin e UPA, bazuar në analizën e bilancit uhor sipas standardeve IWA bazuar në sisteme të sakta informacion, për raportime të sakta dhe të besueshme të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohe.*
- *Shoqëria duhet të punojë në hartimin e një harte të rrjetit me GIS dhe të identifikojë zonat e vjetra, ato me presion të lartë, pra zonat problematike dhe emergjente për ndërhyrje si dhe për krijimin e zonave DMA (district metered area) duke krijuar kështu zona monitorimi në njësitë ku ato nuk evidentohen.*
- *Të planifikohen investime prioritare për rehabilitimin e rrjeteve shpërndarëse problematike dhe zëvendësimin e linjave të amortizuara bazuar në identifikimin e rrjedhjeve në terren veçanërisht në segmentet me amortizim të lartë dhe defekte të përsëritura .*
- *Task- Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes të intensifikojë kontrollet në terren për evidentimin dhe formalizimin e lidhjeve të paligjshme, si dhe përditësimin e databazës së abonentëve, dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e faturuar.*
- *Shoqëria duhet të punojë për të rritur përqindjen e të gjithë konsumatorëve me matës që ky tregues të jetë në nivelin 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe të*

përmirësohet sistemi i matjes përmes instalimit, kalibrimin dhe verifikimit periodik të ujëmatësve në burim, rezervuarë dhe konsumatorë.

- *Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992. Të saktësohen numri i popullsisë së shërbimit dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një të analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Bashkëpunimi sa më koherent dhe efektiv i shoqërisë me institucionin e ERRU-së, për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

12. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje sh.a

Shoqëria rajonale UK Lushnje është formuar nga bashkimi i shoqërive UK Lushnje dhe UK Divjakë. Kjo shoqëri ofron shërbimin e furnizimit me ujë për 109,496 banorë ose për 60% të popullsisë në juridiksionin e saj (referuar raportimit pranë sektorit të monitorimit) nga 56.5 % që ka qënë në vitin 2024. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Lushnje jepen në tabelën nr. 31.

Nga të dhënat e Tabelës nr.31, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 65.5 l/ditë për banorë rezulton jo në normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues. Për këtë shoqëri mund të thuhet se është e vetmja që faturimin aforfe në masën e 144.69 l/ditë për banorë është pothuaj sa norma orientuese prej 150 litra/ditë për banorë.

Rekomandohet një rivlerësim i bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë referuar të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacionalë.

Në veçanti, vlerësimi i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 30. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Lushnje	Popullsia e shërbyer	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	109,496	2,619,020	2,613,530	5,490	27,348	26	65.5	144.6	65.5

Nga ana tjetër referuar tendencës së rritjes së vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën nr. 32, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre të cilat i kemi konsideruar të njëjta me vitet e mëparshme pasi ende nga shoqëria nuk ka një analizë faktike të tyre.

Tabela nr. 31. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Lushnje	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	109,496	6,492,640	65.5	182,401	13,087,440	+ 196.6	+ 131.1

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU

Nga Tabela nr. 32, shihet se shoqëria rajonale UK Lushnje ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit, por nga analiza rezulton në nivele shumë të ulëta konsumi total për banor në ditë dhe kjo sjell një vlerësim joreal të sasisë së disponueshme të ujit, ndërkohë që edhe kapaciteti i burimeve është marrë i pandryshuar. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi, kur aktualisht kjo shoqëri raporton një kohëzgjatje të furnizimit me ujë mesatarisht prej 17 orë.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje sh.a.

Shoqëria Rajonale UK Lushnje, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Lushnje dhe Divjakë, ka në juridiksion 182,401 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet për 109,496 banorë ose 60 % të popullsisë totale. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 29,452 lidhje, nga të cilat 29,405 ose 99,8 % lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës duke ruajtur të njëjtin nivel me vitin 2024.

Nga raportimi i kësaj shoqërie rezulton se për vitin 2025 i gjithë uji i prodhuar në masën 6,492,640 m³ (37,220 më shumë se në vitin 2024) është i matur 100% dhe prodhohet totalisht nga sisteme me ngritje mekanike. Krahasuar me vitin 2024, Uji Pa të Ardhura mbetet pothuaj i pandryshuar në nivelin 54.11% nga 54.13% të ujit që hyn në sistem, ndërsa përqindja e ujit të faturuar u rrit lehte në 45.98% nga 45.87% në vitin 2024, të prodhimit.

Tabela nr.33, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Lushnje.

Tabela nr. 32. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Lushnje sh.a – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	6,492,640	100.00%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar		0.00%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	6,492,640	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,968,618	45.72%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	10,770	0.17%
Faturimi total	2,979,388	45.89%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	122,929	1.89%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	194,779	3.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	585,338	9.02%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	324,634	5.00%
Humbjet e dukshme (administrative)	1,104,751	17.02%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	526,838	8.11%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	105,368	1.62%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	175,613	2.70%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	877,361	13.51%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	600,394	9.25%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	2,285,573	35.20%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	3,390,324	52.22%
UJI PA TË ARDHURA	3,513,252	54.11%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 33:

- Treguesi UPA në nivelin 54.11% të prodhimit vjetor në të njëjtin nivel me vitin 2024 (54.13%), konsiderohet në nivel të papranueshëm dhe shoqëria rajonale duhet të marri masa për përmirësimin e saj.
- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar”, në nivelin 100% është një tregues pozitiv për këtë shoqëri por niveli i lartë i humbjeve sjell në vëmendje dhe ekzistencën e një problematike të menaxhimit jo të kujdesshëm të presioneve në rrjet.

- Konsumi total i faturuar është në nivelin 45.89% dhe vetëm 0.16% është konsum i faturuar i pamatur nga 0.81% në vitin 2024, duke rezultuar kështu me një përmirësim shumë të vogël.
- Niveli i humbjeve reale paraqitet në vlerat e 35.20% nga 30.86 % në vitin 2024 e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, duke rezultuar me një trend negativ/rritës. Peshën më të madhe e zënë humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 13.51% nga 10.81% në vitin 2024, apo nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit që vazhdojnë të jenë pothuaj në të njëjtin nivel me vitin paraardhës pasi rezultojnë 8.11% (8.66% në 2024). Po kështu pothuaj e pandryshuar mbetet edhe niveli i humbjeve për shkak të riparimeve në rrjet në nivelin e 9.25% nga 9.77% në vitin 2024.
- Niveli i humbjeve të dukshme paraqitet e përmirësuar (me zbritje) në vlerën 17.2% nga 22.46% në vitin 2024, e volumit të ujit të prodhuar që futet në sistem, i cili vjen, si rezultat i zvogëlimit të humbjeve nga lidhjet e paligjshme në transmetim dhe shpërndarje në nivelin 3 % dhe 9.02% nga 19.86% nga 16.24% në vitin 2024 të prodhimit vjetor, duke treguar një përmirësim të ndjeshëm të këtyre zërave, ndërsa humbjet nga pasaktësia në matje, nën faturim etj. në nivelin 5% nga 2.06% në vitin 2024 pasqyrojnë një përkeqësim të ndjeshëm.
- Numri i klientëve rezulton 29,452 lidhje, nga të cilat 29,405 ose 99,8 % lidhje janë të pajisur me aparate ujëmatës, por ky tregues rezulton me luhatje pasi pati një përkeqësim në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 ku paraqiteshin në vlerat 29,931 klientë dhe 99.2% të totalit të klientëve e merrnin këtë shërbim, ndaj dhe duhet një shpjegim nga ana e shoqërisë për këtë tregues në mënyrë që të ketë një vlerësim më real të menaxhimit të kërkesës për ujë.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale, dhe në përgjithësi hasen mjaft vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të insistojë nëpërmjet studimeve hidraulike të rrjetit, për identifikimin e zonave me presion të lartë, të shikohet mundësia e instalimeve të valvulave reduktuese të presionit dhe sistemeve të monitorimit online, si dhe të vendos objektiva për uljen graduale të presioneve të tepërta që shkaktojnë rrjedhje në rrjetin e ujësjellësit.*
- *Task-Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë për verifikime në vend për të përcaktuar saktësisht bazën e klientëve, si dhe për të thelluar analizën për të përcaktuar se ku ekziston saktësisht problematika tek matësat duke kolauduar matësat/ndërruar matësat e vjetër, kontrolli i punës së lexuesve të matësve, lidhjet e paligjshme etj.*

- *Rritja e nivelit të Humbjeve reale që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës në nivelin 13.51% nga 10.81% në vitin 2024, apo nga rrjedhjet në rrjetin e transmetimit që vazhdojnë të jenë pothuaj në të njëjtin nivel me vitin paraardhës, kërkojnë një analizë të detajuar të gjendjes teknike të rrjetit, si dhe të bëhen përpjekje për gjendjen e fondeve nga qeveria qendrore ose të planifikohen fonde nga shoqëria rajonale për rehabilitimin ose zëvendësimin e tyre, e cila do të çonte dhe në reduktim akoma më të ndjeshëm të ujit pa të ardhura.*
- *Të trajtojë vazhdimisht stafin teknik në programet kombëtare të humbjeve të ujit të organizuara nga SHUKALB dhe më gjerë, nga të cilët të përcaktohet personi përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara për hartimin e bilancit të ujit.*
- *Bashkëpunimi sa më koherent dhe efektiv i kësaj shoqërie me institucionin e ERRU-së për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e një bilancit të ujit të saktë dhe real, si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

13. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec

Shoqëria Rajonale UK Pogradec është krijuar si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Pogradec (Qytetin Pogradec dhe 7 Njësitë Administrative Buçimas, Hudënisht, Çërravë, Dardhas, Proptisht, Velçan, Trebinjë) dhe njësine administrative Përrenjas (territorin e Bashkisë Përrenjas me gjithë fshatrat e saj), e cila ka qenë zonë shërbimi e ish shoqërisë rajonale UK Librazhd. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UK Pogradec, paraqiten në Tabelën nr. 34.

Analiza e të dhënave të Tabelës nr. 34, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 56.8 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 46.3 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 33. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare më Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Pogradec	Popullsia me shërbim	konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	106,138	2,187,810	2,133,340	54,470	25,365	795	56.8	46.3	56.5

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën nr. 35 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 34. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Pogradec	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	106,138	3,719,590	56.5	116,820	12,922,960	+ 303.1	+ 246.6

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU

Bazuar në të dhënat e Tabelës nr. 35, konstatohet se Shoqëria Rajonale UK Pogradec disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitë përbërëse.

Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec sh.a

Shoqëria Rajonale UK Pogradec, e krijuar nga bashkimi i ish-shoqërive UK Pogradec dhe UK Përrenjas, ofron shërbimin e furnizimit me ujë për rreth 90.8 % të popullsisë brenda juridiksionit të saj, sipas të dhënave të raportuara në sektorin e monitorimit. Numri total i lidhjeve të furnizimit me ujë rezulton 27,950 lidhje, nga të cilat 27,117 lidhje (97%) janë të pajisura me aparate ujëmatëse, duke shënuar përmirësim krahasuar me nivelin prej 96.4% të raportuar në vitin 2024.

Shoqëria Rajonale UK Pogradec ka prodhuar gjatë vitit 2025 një volum prej 3,719,590 m³ ujë, me nivel matjeje 81 %, duke shënuar një përmirësim krahasuar me vitin 2024 (79 %). Megjithatë, mungesa e ujëmatësve në burimet prodhuese mbetet problematike, pasi pa matje të plotë nuk mund të verifikohet realisht prodhimi. Ky hendek teknik krijon pasiguri në bilancin e ujit dhe e vështirëson menaxhimin e humbjeve.

Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) rezulton në nivelin 34.96% të sasisë së ujit që hyn në sistem, duke mbetur pothuajse i pandryshuar krahasuar me dy vitet e fundit. Shoqëria faturon 2,419,320 m³ ujë, që përfaqëson 65.04% të volumit total të prodhuar. **Në tabelën nr. 36**, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Pogradec.

Tabela nr. 35. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Pogradec sh.a. – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	3,010,859	80.95%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	708,731	19.05%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem total	3,719,590	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	2,363,450	63.54%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	55,870	1.50%
Faturimi total	2,419,320	65.04%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	50,124	1.35%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	52,124	1.40%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	56,200	1.51%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	100,524	2.70%
Humbjet e dukshme (administrative)	208,848	5.61%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	260,372	7.00%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	59,514	1.60%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	52,075	1.40%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	647,424	17.41%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	21,913	0.59%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,041,298	27.99%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	1,250,146	33.61%
UJI PA TË ARDHURA	1,300,270	34.96%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 36:

- Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA), në nivelin 34.96% të prodhimit vjetor, rezulton pothuajse në të njëjtin nivel me vitet 2023 dhe 2024. Megjithëse ky tregues mbetet afër mesatares së sektorit në nivel kombëtar, gjykojmë se me një angazhim të mëtjshëm nga shoqëria mund të arrihet përmirësimi i mëtjshëm i këtij treguesi të rëndësishëm të performancës.
- Niveli i matjes së ujit të prodhuar ka arritur në 80.95 %, krahasuar me 79% të raportuar në vitin 2024. Megjithatë, shoqëria duhet të ndërmarrë hapa të mëtjshëm për sigurimin e fondeve dhe instalimin e ujëmatësve në të gjitha burimet e furnizimit me ujë, me qëllim përmirësimin e saktësisë së bilancit të ujit.
- Humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit (1.4%) dhe në rrjetin e shpërndarjes (1.51%) tregojnë një nivel relativisht të kontrolluar të këtij fenomeni dhe pasqyrojnë përpjekjet e shoqërisë për menaxhimin dhe reduktimin e tij. Këta tregues mbeten pothuajse në të njëjtat nivele krahasuar me vitin 2024.
- Humbjet nga rrjedhjet në linjat e transmetimit kanë arritur në 7% të prodhimit vjetor, nga 6.1% në vitin 2024, ndërsa humbjet në rrjetin e shpërndarjes rezultojnë në 17.41%, krahasuar me 19.28% në vitin 2024. Këto rezultate kërkojnë verifikime të mëtjshme në terren dhe analiza të detajuara për të identifikuar faktorët që ndikojnë në ndryshimin e tyre.
- Konsumatorët e pajisur me ujëmatës përbëjnë rreth 97% të numrit total të klientëve. Megjithatë, për një menaxhim sa më efektiv të kërkesës për ujë dhe përmirësimin e cilësisë së matjes, rekomandohet që ky tregues të afrohet sa më shumë me nivelin 100%.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk realizohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar sipas zonave të matjes (DMA) në të gjithë territorin e shërbimit, çka kufizon mundësitë për identifikimin dhe adresimin e shpejtë të problematikave në rrjet.
- Nga analiza e kryer rezulton se Sh.R. UK Pogradec ka regjistruar një rritje të humbjeve administrative me 0.65%, ndërsa humbjet reale janë përmirësuar me 0.49% krahasuar me vitin 2024. Në tërësi, niveli i humbjeve totale dhe i Ujit Pa të Ardhura ka mbetur pothuajse i pandryshuar krahasuar me vitin paraardhës.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të ndërmarrë masa për sigurimin e fondeve, qoftë nga burimet e brendshme financiare apo nga programet e financimit të qeverisë qendrore, për instalimin e ujëmatësve në të gjitha burimet e furnizimit me ujë. Kjo është një domosdoshmëri për garantimin e matjes së saktë të prodhimit dhe hartimin e një bilanci uji sa më realist dhe të besueshëm.*
- *Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për projektimin dhe implementimin e sistemeve DMA në të gjithë zonën e shërbimit. Këto sisteme do të mundësojnë monitorimin, analizimin dhe diagnostikimin e humbjeve në rrjet, si dhe identifikimin dhe zbatimin e masave konkrete për reduktimin e tyre dhe përmirësimin e bilancit të ujit.*
- *Shoqëria duhet të kryejë analiza të detajuara në terren për identifikimin e shkaqeve reale të rritjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes, duke adresuar në mënyrë të veçantë faktorët që ndikojnë në rritjen e humbjeve teknike dhe duke përcaktuar masat përkatëse për minimizimin e tyre.*
- *Duhet të planifikohen dhe të sigurohen fondet e nevojshme për rritjen e përqindjes së konsumatorëve të pajisur me ujëmatës në të gjitha kategoritë e klientëve, me synimin që niveli i matjes të afrohet sa më shumë me 100%. Kjo do të mundësojë një menaxhim më efikas të kërkesës për ujë dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, veçanërisht në rastet kur të dhënat e raportuara rezultojnë me besueshmëri të kufizuar.*
- *Rekomandohet vazhdimi i investimeve në zhvillimin profesional të stafit teknik përmes pjesëmarrjes në programe kombëtare dhe ndërkombëtare për menaxhimin e humbjeve të ujit. Prioritet duhet t'u jepet specialistëve të angazhuar në monitorimin, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave, me qëllim përmirësimin e cilësisë së raportimit dhe hartimin e bilanceve të sakta të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit.*
- *Shoqëria duhet të sigurojë funksionimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të informacionit, në mënyrë që raportimi i të dhënave të jetë i plotë, i saktë dhe i besueshëm. Gjithashtu, rekomandohet përditësimi i të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe territorin nën juridiksion, në përputhje me statistikën zyrtare të INSTAT, për të garantuar analiza më të sakta mbi përdorimin dhe kërkesën për ujë.*
- *Duhet të hartohet një plan veprimi me prioritet të qarta për instalimin e ujëmatësve, me fokus të veçantë në banesat individuale dhe zonat rurale, ku niveli i matjes paraqet ende potencial për përmirësim.*

- *Task-Forca e ngritur për evidentimin e lidhjeve të paligjshme duhet të pajiset me mjetet dhe logjistikën e nevojshme për të ushtruar kontrole sistematike në terren. Aktiviteti i saj duhet të fokusohet në identifikimin e lidhjeve të paligjshme, anashkalimeve të ujëmatësve, lidhjeve dytësore, klientëve të paregjistruar, si dhe në verifikimin e procesit të leximit të matësve dhe evidentimin e rasteve të ujit të pafaturuar.*
- *Për lidhjet pa ujëmatës, në rastet kur instalimi i tyre nuk është i mundur, duhet të verifikohet numri i banorëve përmes dokumentacionit përkatës dhe faturimi të kryhet në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.*
- *Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit institucional me ERRU-në për tejkalimin e vështirësive që lidhen me hartimin e bilancit të ujit dhe raportimin e tij brenda afateve të përcaktuara. Bilanci i ujit duhet të përgatitet dhe të dorëzohet rregullisht në fillim të çdo viti.*

14. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë sh.a

Shoqëria rajonale UK Sarandë përbëhet nga ish shoqëritë UK ose Njësitë, përkatësisht UK Sarandë, UK Finiq, UK Delvinë dhe UK Konispol. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh R UK Sarandë jepen në tabelën nr. 37.

Nga të dhënat e Tabelës nr. 37, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 64.9 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 51.2 l/ditë për banor. Në të dy rastet, niveli i konsumit mbetet dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikatat e faturimit apo me faktor të tjerë operacional.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 36. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Sarandë	Popullsia me shërbim	konsumi total në m ³	Konsumi I matur në m ³	Konsumi I pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	100,080	2,346,400	2,250,800	95,600	26,662	1,437	64.9	51.2	64.2

Menaxhimi sa me efektiv i burimeve të ujit për konsum publik dhe nga ana tjetër tendenca në rritje të vazhdueshme e kërkesës për ujë, kërkojnë një vlerësim real të këtyre burimeve dhe rezervave që ato kanë në kushtet kur shpesh po përballemi me dukurive tepër shqetësuese për shkak të ndryshimeve klimatike të shoqëruara dhe nga ndryshime demografike. Ky vlerësim ka si synim evidentimin e këtyre rezervave ujore në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën nr. 38, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre për të cilat ende nuk kemi pasi një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 37. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Sarandë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	100,080	5,717,000	64.2	125,529	27,097,648	+ 591.4	+ 527.2

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Nga tabela nr. 38, shihet se shoqëria rajonale UK Sarandë ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve të ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë sh.a.

Shoqëria Rajonale UK Sarandë, e krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Sarandë, Konispol, Finiq dhe Delvinë, ka nën juridiksion 125,529 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet vetëm për 100,080 ose 79.73% të popullsisë totale. Numri i lidhjeve totale për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 32,757 lidhje ose 95.55 % janë të pajisur me aparate ujëmatës nga 95.17 % që rezultonte në vitin 2024, duke rezultuar pothuaj i pandryshuar.

Prodhimi vjetor 5,717,000 m³ (1,408,060 m³ më pak krahasuar me vitin 2024) rezulton i matur në nivelin 80.50 % nga 78.6 % në vitin 2024. Ulja e volumit të ujit të prodhuar dhe rritja e sasisë së ujit të matur tregon për një menaxhim më të mirë nga ana e shoqërisë, por nga ana tjetër ngelet evidente nevoja për aparate ujëmatës në të gjitha pikat prodhuese ku ato mungojnë.

Uji Pa të Ardhura rezulton në nivelin 45.63% të ujit që hyn në sistem, shoqëria faturon vetëm 3,108,160m³ ujë ose 54.37 % të prodhimit.

Tabela nr. 39, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. R UK Sarandë sh.a..

Tabela nr. 38. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Sarandë sh.a – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar i matur	4,602,000	80.50%
Volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar	1,115,000	19.50%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	5,717,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,012,560	52.69%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	95,600	1.67%
Faturimi total	3,108,160	54.37%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	57,170	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	114,340	2.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	513,530	8.98%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	97,228	1.70%
Humbjet e dukshme (administrative)	725,098	12.68%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	227,420	3.98%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	57,170	1.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	114,340	2.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	856,150	14.98%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	571,492	10.00%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,826,572	31.95%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,551,670	44.63%
UJI PA TË ARDHURA	2,608,840	45.63%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 39:

- Treguesi UPA në nivelin 45.63% të prodhimit vjetor nga 57.59 % në vitin 2024, tregon për një përmirësim të konsiderueshëm nga viti 2024 me 11.95 % dhe ruajtjen e këtij trendi pozitiv që nga viti 2023, megjithatë nga shoqëria kërkohet me insistim punë e vazhdueshme për përmirësimin e këtij treguesi.

- Niveli i matjes për faktorin “Uji i prodhuar” në masën 80.5 %, dhe përmirësimi krahasuar me vitin 2024, tregon për mundësitë që ka shoqëria, ndaj dhe nga ana e saj kërkohet vazhdimi i përpjekjeve për vendosjen e aparateve ujëmatës në të gjitha pikat prodhuese ose burimet e shfrytëzueshme.
- Vihet re që humbjet administrative, megjithëse në përmirësim, përsëri niveli 12.68% (nga 14.6% në vitin 2024) konsiderohet i lartë. Ato vazhdojnë të dominohen nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarje konkretisht në nivelin 8.98% nga 10.01 % në vitin 2024.
- Humbjet teknike rezultojnë në nivelin 31.95% nga 41.99 % në vitin 2024 duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm të këtyre humbjeve dhe ulje të vlerave të gjithë elementeve të këtyre humbjeve. Peshën më të madhe në humbjet teknike e zënë humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes në nivelin e 14.98% nga 18.97 % në vitin 2024, dhe humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetllësimit në nivelin 10% nga 15.01 % që rezultojnë një vit më parë. Këto humbje mbeten të larta prandaj, duhen dhënë argumenta të mëtijshme për justifikimin e tyre.
- Konsumatorët familjare me matje përbëjnë rreth 81.4% të numrit total të konsumatorëve nga 80.75 % në vitin 2024, megjithëse e në përmirësim kërkohet të jetë sa më afër nivelit 100% të matjes në mënyrë që të arrihet një menaxhim korrekt i kërkesës për ujë.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve, megjithëse kanë sisteme të ndara në DMA (sidomos zonat urbane Sarandë e Delvinë), nuk arrijnë të kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të saktë për mungesë të matësive në këto zona, apo për mungesën e ndarjes në DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Kjo tregon në përgjithësi se ka vështirësi për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit për çdo njësi të shoqërisë rajonale.

Rekomandime:

- *Niveli i matjes së ujit të prodhuar është 80.5 % është një tregues se megjithëse në përmirësim nevoja për investime në ujë matësa në prodhim për të gjitha burimet është e domosdoshme.. Shoqëria duhet të marrë masa për alokim të fondeve nga qeveria qendrore apo burimet e brendshme të saj për pajisjen me matësa të çdo burimi në mënyrë që të kemi një bilanc uji bazuar në matje reale të sasisë së ujit që hyn në sistemin e furnizimit me ujë të shoqërisë.*
- *Shoqëria duhet të vlerësojë si emergjente pajisjen me matësa eficientë të sistemeve ekzistuese DMA, si dhe të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë. Kjo do të mundësojë një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*

- *Shoqëria duhet të investojë realisht në burimet njerëzore përgjegjëse për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA ekzistuese si dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale. Gjithashtu të insistohet që Bilanci i Ujit të trajtohet jo thjesht si një statikë por si analizë reale që evidenton gjithë problematikën që shoqëria ka lidhur me sistemet e ujësjellësit*
- *Menaxhim racional i kërkesës për ujë si dhe minimizimi i humbjeve sidomos ato administrative arrihet vetëm dhe sidomos kur përqindja e konsumatorëve familjare me matës të jetë sa më afër nivelit 100%, ndaj shoqëria duhet të marrë masa për të arritur këtë tregues i cili megjithëse në përmirësim krahasuar me vitin 2024, tregon se duhet ende pune për arritjen e nivelit të kërkuar.*
- *Struktura e Task Forcës vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të verifikojë në terren për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, të kontrollojë punën e lexuesve të matësave dhe në përgjithësi të evidentojë problematikën me ujin e nën faturuar. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banorëve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Problematika nuk është e njëjtë për çdo njësi ndaj është e domosdoshme një analizë për secilën njësi dhe më pas një vlerësim i konsoliduar në nivel rajonal, duke hartuar kështu dhe një guidë në procesin e evidentimit të nivelit të humbjeve në të gjithë zonën e juridiksionit të shoqërisë.*
- *Bashkëpunim sa më koherent dhe efektiv i shoqërisë, me institucionin e ERRU-së për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e një bilancit të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

15. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër sh.a.

Shoqëria Rajonale UK Shkodër, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Shkodër, Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësia e Madhe. Shërbimin i FU i ofrohet 180,533 banorëve ose 53.9 % të popullsisë në juridiksion nga 52.5% që ishte në vitin 2024, sipas të dhënave të raportuar nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit. Të dhëna të përgjithshme në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banor me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Sh. R UK Shkodër sh.a. jepen në tabelën 40.

Nga të dhënat e Tabelës nr.40, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur prej 49.19 l/ditë për banor pasqyron nivel të konsumit dukshëm

nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues, por edhe faturimi aforfe në masën 105.8 litra/ditë për banorë është jo sa norma orientuese prej 150 litra/ditë për banorë.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacional.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 39. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfes

Sh.R. Shkodër	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr.lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	180,533	4,115,742	2,472,905	1,642,837	32,275	9,946	49.1	105.8	62.5

Nga ana tjetër referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në tabelën 41, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit për popullsinë e shërbyer jepen dhe kapaciteti i burimeve ujore që shfrytëzon kjo shoqëri për furnizimin me ujë të popullatës, por vlen të citojmë që nuk kemi të dhëna të përditësuara të këtij treguesi.

Tabela nr. 40. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. Shkodër	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	180,533	13,000,760	62.5	334,968	49,927,854	+ 408.4	+ 345.9

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Nga Tabela nr.41, shihet se shoqëria rajonale UK Shkodër ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë, për popullsinë totale të regjistruar në zonën e saj të shërbimit sipas të dhënave të raportuara nga vet shoqëria, pasi rezulton se ka një sasi të disponueshme prej 408.4l/ditë për banor, kur konsumi total i matur dhe aforfe është 64.8 l/ditë, banor nga 66.5 l/ditë, banor që rezultonte në vitin 2024. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të vazhdojë të jetë prioritet mbrojtja e burimeve ujore nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të tyre, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë, megjithëse dhe gjatë 2025 vihet re ulje e sasisë së prodhimit të ujit që futet në sistemet e kësaj shoqërie rajonale, si dhe reduktim i humbjeve të ujit në të gjitha njësitet përbërëse.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër

Shoqëria Rajonale UK Shkodër, është krijuar nga bashkimi i ish shoqërive UK Shkodër, Fushë Arrëz, Pukë, Vau i Dejës dhe Malësia e Madhe. Kjo shoqëri ka në juridiksion 334,968 banorë sipas raportimit pranë sektorit të monitorimit. Shërbimin i FU i ofrohet 180,533 banorëve ose 53.9% nga 52.5% në vitin 2024 të popullsisë totale. Vihet re një rritje e popullsisë së shërbyer, pavarësisht saktësisht të numrit të popullsisë totale në juridiksion krahasuar me vitin 2024. Numri i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet 46,976 nga 46,436 lidhje në vitin 2024, nga të cilat 36,628 ose 77.9 % janë të pajisur me matësa uji nga 76.9% që rezultonte në 2024.

Prodhimi vjetor në masën 13,000,760 m³ (1,122,330 m³ më pak se viti 2024) i vlerësuar në nivelin e 97.73%, evidentojnë mungesën e matësive në pothuaj të gjithë burimet, dhe vlerësimi i sasisë së ujit që hyn në sistem shton marzhin e pasaktësive të gjithë vlerave të bilancit të ujit. UPA është në nivelin 61.68% nga 64% në vitin 2024 të ujit që hyn në sistem, dhe vazhdon të ruaj trendin e përmirësimit që prej vitit 2022. Shoqëria faturon vetëm 4,982,335 m³ ujë ose 38.32% të ujit që prodhon nga 36 % në vitin 2024. **Tabela nr. 42**, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. R UK Shkodër sh.a.

Tabela nr. 41. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Shkodër sh.a. – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar i matur	295,260	2.27%
Volumi i ujit të prodhuar i vlerësuar	12,705,500	97.73%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	13,000,760	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,252,562	25.02%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	1,729,773	13.31%
Faturimi total	4,982,335	38.32%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	41,556	0.32%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	63,488	0.49%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	6,717,758	51.67%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	183,312	1.41%

Humbjet e dukshme (administrative)	6,964,558	53.57%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	210,998	1.62%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	101,010	0.78%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	161,585	1.24%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	467,538	3.60%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjetës	71,180	0.55%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,012,311	7.79%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	7,976,869	61.36%
UJI PA TË ARDHURA	8,018,425	61.68%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 42:

- Treguesi UPA në nivelin e 61.68% nga 64% në vitin 2024 të prodhimit vjetor, megjithëse në trend zbritës referuar tre viteve të fundit konsiderohet mjaft e lartë dhe që duhet patjetër duhet përmirësuar.
- “Uji i prodhuar që futet në sistem” pothuajse totalisht i vlerësuar (97.73%) i bën jo të besueshme të gjitha vlerat absolute të vëllimeve të ujit që janë komponentë të bilancit të ujit.
- Vlen të theksohet se në vitin 2025 shoqëria raporton se mat vetëm 2.27% të ujit të prodhuar nga 70% që rezultonte në vitin 2024, dhe kjo jo vetëm që i bën të pabesueshme të gjitha të dhënat e bilancit të ujit, por kërkon përgjegjshmëri dhe argumentime teknike të nevojshme për të justifikuar këtë situatë.
- Konsumi total i faturuar është në nivelin 38.32% nga 36% në vitin 2024, ndërsa konsumi i faturuar i pamatur rezulton në nivelin 13.31% nga 12.5% që rezultonte në vitin 2024.
- Numri i lidhjeve me matës prej 78% nga 76.9% në vitin 2024 të totalit të klientëve, megjithëse në rritje konsiderohet i papranueshëm pasi për një menaxhim korrekt të “Kërkesës për Ujë”, ky parametër duhet të jetë sa më afër 100%.
- Numri i lidhjeve të klientëve familjar me matës është 32,279 ose 87.9 % e totalit të klientëve me matës.
- Niveli i humbjeve të dukshme është 53.57% nga 56.83% në vitin 2024, ku humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës në nivelin e 51.67% nga 54.22%, megjithëse e përmirësuar zënë rreth 96.4% nga 95% të këtyre humbjeve në vitin 2024.

- Niveli i humbjeve reale në nivelin 7.79% nga 6.68% në vitin 2024 pasqyron një trend përkeqësues të këtyre humbjeve, sidomos humbjet nga rrjedhjet në rrjetin shpërndarës të cilat rezultojnë në nivelin e 3.6% nga 1.61% që rezultonin në vitin 2024.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe në zona të ndara me matje (DMA) në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, si dhe hasen mjaft vështirësi nga stafi i shoqërisë për monitorimin e humbjeve dhe hartimin e bilancit të ujit në të gjithë zonën e shërbimit.
- Nga analizimi i humbjeve të ujit në sistem, rezulton se humbjet administrative vazhdojnë të jenë të larta dhe zënë rreth 87% nga 90% të totalit të humbjeve që rezultonin në vitin 2024, ku humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës zënë rreth 51.67% megjithëse me të ulëta krahasuar me vitin 2024, evidentojnë kështu nevojën emergjente për kontrollin dhe monitorimin më efikas të rrjetit shpërndarës në gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të kryejë një analizë të hollë teknike dhe operacionale për të identifikuar arsyet e rënies drastike të ujit të prodhuar të matur. Gjithashtu të hartojë një plan veprimi për rikthimin e matjes së saktë të ujit të prodhuar përmes instalimit, kalibrimit dhe zëvendësimit të matësave funksionalë.*
- *Shoqëria të insistojë në financimin dhe zbatimin e projekteve për sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, për të mundësuar monitorimin, evidentimin dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të marrë masa për rritjen e përqindjes së konsumatorëve familjare me matës, pasi ky tregues vazhdon të mbetet në nivelet 88%, dhe prioritet të kenë instalimi i matësve në shtëpitë private, kryesisht në zonat rurale për një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme, sipas një plani veprimi të hartuar nga shoqëria.*
- *Niveli ende i lartë i lidhjeve të paligjshme në nivelet e 51.67 %, kërkon nga shoqëria angazhim serioz në hartimin dhe zbatimin e një plani konkret veprimi për të përcaktuar sa më saktë bazën e klientëve dhe në bashkëpunim me Taks -Forcën e ngritur, me mbështetjen e njësisë respektive të qeverisjes vendore, të jetë në veprim në terren, me verifikime në vend për anashkalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, të kontrollojë punën e lexuesve të matësve dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikes me ujin e nën faturuar.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, duke dokumentuar dhe argumentuar teknikisht metodologjinë e përdorur për ujin e vlerësuar, pasi mungesa e matjeve të besueshme cënon saktësinë e bilancit të ujit dhe vlerësimin real të humbjeve.*

- *Shoqëria duhet të investojë realisht në burimet njerëzore përgjegjëse për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilancit të ujit Gjithashtu të insistohet që Bilanci i Ujit të trajtohet jo thjesht si një statistikë por si analizë reale që evidenton gjithë problematikën që shoqëria ka lidhur me sistemet e ujësjellësit.*
- *Bashkëpunimi sa më koherent dhe efektiv me institucionin e ERRU-së për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e një bilancit të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit*

16. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Vlorë sh.a.

Shoqëria Rajonale UK Vlorë është krijuar si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Vlorë, UK Himarë dhe UK Selenicë. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë Rajonale UK Vlorë, paraqiten në Tabelën nr. 43.

Analiza e të dhënave të Tabelës nr. 43, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 55.3 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 102.4 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 42. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjarë me Matje dhe Aforfe

Sh.R. UK Vlorë	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m3	Konsumi i matur ne m3	Konsumi i pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	222,375	5,455,000	3,352,000	2,103,000	49,889	16,894	55.3	102.4	67.2

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është

e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë.

Për këtë qëllim, në Tabelën nr. 44 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 43. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.R. UK Vlorë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	222,375	26,010,000	67.2	250,513	46,687,326	+ 510.6	+ 443.4

*Nr.i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU

Bazuar në të dhënat e Tabelës 44, konstatohet se Shoqëria Rajonale UK Vlorë disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitë përbërëse. Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë

Shoqëria Rajonale UK Vlorë është krijuar si rezultat i bashkimit të ish-shoqërive UK Vlorë, Himarë dhe Selenicë. Numri total i lidhjeve për shërbimin e furnizimit me ujë raportohet në 74,125 lidhje, nga të cilat 56,223 lidhje ose 75.85% janë të pajisura me ujëmatës.

Prodhimi vjetor i ujit raportohet në nivelin 26,010,000 m³, i vlerësuar 100%, çka evidenton mungesën e matjes së prodhimit në burimet dhe pikat prodhuese. Uji Pa të Ardhura (UPA) rezulton në nivelin 72.79%, kundrejt 73.55% në vitin 2024, duke shënuar një përmirësim prej 0.76 %. Shoqëria faturon 7,078,000 m³ ujë, ose 27.21% të prodhimit total, krahasuar me 26.45% të raportuar në vitin 2024.

Tabela nr. 45, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. Rajonale UK Vlorë.

Tabela nr. 44. Bilanci i Ujit për Shoqërinë Rajonale UK Vlorë sh.a – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	0	0%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	26,010,000	100%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	26,010,000	100%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	4,785,000	18.40%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	2,293,000	8.82%
Faturimi total	7,078,000	27.21%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	5,000	0.02%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	1,467,765	5.64%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	5,302,930	20.39%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	2,452,000	9.43%
Humbjet e dukshme (administrative)	9,222,695	35.46%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	4,904,685	18.86%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	670,235	2.58%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	90,000	0.35%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	3,384,514	13.01%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	654,871	2.52%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	9,704,305	37.31%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	18,927,000	72.77%
UJI PA TË ARDHURA	18,932,000	72.79%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 45:

- Treguesi UPA në nivelin 72.79% pasqyron një përmirësim të lehtë prej 0.76% krahasuar me vitin 2024. Megjithatë, niveli mbetet i lartë dhe konsiderohet i papranueshëm për standardet e sektorit, duke kërkuar ndërhyrje të vazhdueshme për reduktimin e humbjeve.
- Niveli i matjes së faktorit “Uji i Prodhuar” vazhdon të jetë 0%, duke treguar mungesën e pajisjeve matëse në pikat e prodhimit. Si rrjedhojë, volumi i ujit të prodhuar bazohet në vlerësime, duke ulur besueshmërinë e të gjithë komponentëve të bilancit të ujit.
- Konsumi total i faturuar përfaqëson 27.21% të volumit të prodhuar, kundrejt 26.45% në vitin 2024. Nga ky volum, 18.40% përbën konsum të faturuar të matur.
- Numri i klientëve familjarë të pajisur me ujëmatës ka shënuar rritje, nga 47,454 klientë në vitin 2024 në 49,889 klientë në vitin 2025, duke përfaqësuar 74.7% të totalit të klientëve familjarë, kundrejt 72.5% një vit më parë.

- Humbjet reale raportohen në nivelin 37.31% të volumit të ujit të futur në sistem, me një përkeqësim prej 6.99% krahasuar me vitin 2024. Kontributin kryesor e japin rrjedhjet në rrjetin e transmetimit, të cilat arrijnë në 18.86% (nga 15.11% në vitin 2024), ndërsa rrjedhjet në rrjetin shpërndarës raportohen në nivelin 13.01%, me rritje prej 2.94%. Humbjet për shkak të riparimeve përbëjnë 2.52%. Këto të dhëna tregojnë se humbjet fizike në sistem vazhdojnë të mbeten në nivele të larta.
- Humbjet e dukshme vlerësohen në 35.46% të volumit të ujit të futur në sistem dhe lidhen kryesisht me lidhjet e paligjshme, pasaktësitë në matje, nënfaturimin dhe faktorë të tjerë administrativë.
- Procesi i vlerësimit dhe analizimit të humbjeve nuk kryhet në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk mbështetet në monitorim të organizuar përmes zonave të matjes (DMA), gjë që kufizon identifikimin dhe menaxhimin efektiv të humbjeve në sistem.

Analiza tregon se besueshmëria e treguesve mbetet e kufizuar për shkak se prodhimi i ujit vazhdon të vlerësohet dhe jo të matet. Megjithatë UPA ka shënuar një përmirësim modest prej 0.76% krahasuar me vitin 2024, struktura e humbjeve tregon rritje të humbjeve reale dhe ulje të humbjeve të dukshme. Në të njëjtën kohë, volumi i faturuar është rritur me rreth 31,000 m³, ndërsa në terma përqindjeje është rritur me 0.76%, duke reflektuar një përmirësim të kufizuar të performancës së shoqërisë në menaxhimin e ujit dhe reduktimin e humbjeve.

Rekomandime:

- *Shoqëria duhet të ndërmarrë masa emergjente për sigurimin e fondeve të nevojshme për instalimin e ujëmatësve në të gjitha pikat e prodhimit. Matja reale e ujit të prodhuar është kusht themelor për hartimin e një bilanci të saktë dhe të besueshëm të ujit.*
- *Duke qenë se volumi i ujit të prodhuar vazhdon të përcaktohet mbi baza vlerësuese dhe jo përmes matjes direkte, të gjithë komponentët e bilancit të ujit mbeten të ekspozuar ndaj pasaktësive. Për këtë arsye, prioritet duhet t'i jepet pajisjes së burimeve dhe impianteve prodhuese me sisteme matjeje të certifikuara.*
- *Shoqëria duhet të hartojë dhe zbatojë një plan të detajuar për krijimin e zonave të matjes dhe monitorimit (DMA) në të gjithë territorin e shërbimit. Kjo do të mundësojë identifikimin e saktë të humbjeve, monitorimin e performancës së rrjetit dhe ndërmarrjen e masave efektive për reduktimin e tyre.*
- *Duhet të vazhdojnë përpjekjet për rritjen e nivelit të matjes së konsumatorëve familjarë, me fokus të veçantë në instalimin e ujëmatësve në banesat private dhe zonat rurale. Aktualisht, 16,894 klientë*

familjarë rezultojnë ende pa matës, duke përfaqësuar 25.3% të totalit të klientëve familjarë. Objektivi duhet të jetë afrimi sa më shumë me mbulimin 100% të konsumatorëve me matje.

- *Humbjet reale, të cilat raportohen në nivelin 37.31%, kërkojnë analizë të detajuar teknike dhe monitorim të vazhdueshëm në terren. Shoqëria duhet të identifikojë segmentet problematike të rrjetit, të hartojë projekte rehabilitimi dhe të sigurojë financime për reduktimin e rrjedhjeve në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes.*
- *Në lidhje me humbjet e dukshme, veçanërisht ato që lidhen me pasaktësitë në matje, nënfaturimin dhe administrimin e konsumit, rekomandohet kryerja e analizave të detajuara për identifikimin e shkaqeve kryesore. Duhet të intensifikohen programet e kalibrit dhe zëvendësimit të ujëmatësve të amortizuar, si dhe kontrolli i proceseve të leximit dhe faturimit.*
- *Është e nevojshme rritja e efektivitetit të kontroleve në terren për evidentimin e lidhjeve të paligjshme, anashkalimin e ujëmatësve dhe rasteve të konsumit të pafaturuar. Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të kontrollit, sektorit të shitjes dhe njësive të qeverisjes vendore duhet të forcohet më tej.*
- *Shoqëria duhet të përmirësojë dhe mirëmbajë sistemet e informacionit dhe bazat e të dhënave, me qëllim garantimin e raportimeve të sakta dhe të besueshme për treguesit operacionalë dhe financiarë. Gjithashtu, rekomandohet verifikimi periodik i të dhënave të popullsisë së shërbyer dhe i zonës së juridiksionit, sepse vihet re që nuk korrespondojnë me ato të publikuara nga INSTAT dhe kjo sjell një analizë joreale të situatës lidhur me përdorimin e ujit.*
- *Duhet të vijojë trajnimi i stafit teknik dhe administrativ në fushën e menaxhimit të humbjeve të ujit, si dhe të caktohen përgjegjësi të qarta për monitorimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave të bilancit të ujit në nivel DMA dhe në nivel të gjithë shoqërisë.*
- *Rekomandohet forcimi i bashkëpunimit me ERRU për përmirësimin e metodologjisë së hartimit të bilancit të ujit, si dhe dorëzimi në kohë i raporteve dhe dokumentacionit përkatës, në përputhje me kërkesat rregullatore dhe afatet e përcaktuara.*

17. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Tiranë sh.a.

Shoqëria UK Tiranë ka nën juridiksion 864,323 banorë. Mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë realizohet për 943,597 banorë ose 109,17 % të popullsisë totale. Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë UK Tiranë, paraqiten në Tabelën nr. 46. Analiza e të dhënave të Tabelës 46, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se

konsumi i matur i ujit rezulton 76.4 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 105.4 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 45. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.a UK Tiranë	Popullsia me shërbim	konsumi total ne m3	Konsumi i matur ne m3	Konsumi i pamatur ne m3	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banor	l/ditë, banor	l/ditë, banor
Viti 2025	943,597	27,226,000	23,882,600	3,343,400	224,677	22,781	76.4	105.4	79.1

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën nr. 47 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 46. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh.a UK Tiranë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futët në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m3)	(l/ditë, banor)		(në m3/vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	943,597	105,829,052	79.1	864,323	104,082,700	+ 329.9	+ 250.8

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Bazuar në të dhënat e Tabelës nr. 47, konstatohet se Shoqëria UK Tiranë disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit. Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitë përbërëse. Këto masa do të kontribuojnë në

arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë UK Tiranë sh.a.

Për vitin 2025, shoqëria UK Tiranë ka raportuar prodhimin total në sasinë 105,829,052 m³ ujë, i cili rezulton i matur në nivelin 64.78 % ndërsa pjesa tjetër vlerësohet. Numri total i lidhjeve të furnizimit me ujë është 288,959 lidhje, nga të cilat 265,756 lidhje (91.97%) janë të pajisura me aparate ujëmatëse. Rrjeti i shpërndarjes së ujit nuk është i organizuar në Zona të Pavarura Matjeje (DMA), duke kufizuar mundësitë për monitorimin efektiv të humbjeve dhe identifikimin e zonave problematike. Kjo situatë vështirëson hartimin dhe zbatimin e strategjive të orientuara për reduktimin e humbjeve në sistem.

Treguesi i Ujit Pa të Ardhura (UPA) rezulton në nivelin 62.77%, një vlerë që konsiderohet e lartë dhe e papranueshme sipas standardeve të performancës së sektorit. Menaxhimi i rrjeteve paraqet vështirësi të konsiderueshme për shkak të shtrirjes së gjerë territoriale dhe zhvillimeve të pakontrolluara në rrjet ndër vite. Vlerësohet se humbjet reale përbëjnë pjesën më të madhe të UPA-së, ndërsa komponenti “pasaktësi në matje dhe nënfaturim” përfaqëson 18.18% të prodhimit vjetor, nivel që kërkon ndërhyrje të menjëhershme.

Monitorimi i bilancit të ujit gjatë viteve të fundit ka evidentuar pasaktësi në vlerësimin e disa komponentëve përbërës, duke treguar nevojën për forcimin e kapaciteteve teknike dhe përmirësimin e metodologjisë së raportimit. Analiza e bilancit të ujit për vitin 2025 tregon një përkeqësim të lehtë të treguesit krahasuar me vitin 2024, çka kërkon angazhim të shtuar institucional dhe teknik për reduktimin progresiv të nivelit të UPA-së.

Tabela nr. 48, paraqet komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për vitin 2025, për Sh. a UK Tiranë.

Tabela nr. 47. Bilancit i Ujit për Shoqërinë UK Tiranë- Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	68,556,501	64.78%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	37,272,551	35.22%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	105,829,052	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	36,014,900	34.03%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	3,389,900	3.20%
Faturimi total	39,404,800	37.23%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	138,805	0.13%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	2,690,692	2.54%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,694,560	4.44%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nënfaturim etj.	19,236,592	18.18%

Humbjet e dukshme (administrative)	26,621,844	25.16%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	3,263,820	3.08%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	2,101,418	1.99%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	2,203,659	2.08%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	17,943,100	16.95%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësllësit	14,151,606	13.37%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	39,663,603	37.48%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	66,285,447	62.63%
UJI PA TË ARDHURA	66,424,252	62.77%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 48:

- Niveli i UPA-së prej 62.77% e klasifikon shoqërinë në një nivel të ulët performance dhe kërkon masa prioritare për përmirësim.
- Shkalla e matjes së treguesit “Uji i Prodhuar” në vlerën prej 64.78 %, mbetet e pamjaftueshme për të garantuar besueshmëri të plotë të bilancit të ujit dhe të vetë treguesit UPA, pasi mungesa e matësive të ujit ndikon si në faturim ashtu dhe në cilësinë e shërbimit për konsumatorët, mungesë motivimi për kursim uji, apo konsum të panevojshëm.
- Vlerësimi jo korrekt i komponentëve përbërës të bilancit të ujit vë në dyshim vërtetësinë e vlerës absolutë të volumit të ujit të prodhuar dhe njëkohësisht treguesit UPA.
- Faturimi total 37.23 % matet në nivelin 91.4 % ndërsa 91.97 % e konsumatorëve janë të pajisur me aparate ujëmatës.
- Konstatohet se humbjet administrative 25.16 % shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në transmetim 2.54 % dhe shpërndarje 4.44 % si dhe nga pasaktësia në matjen e ujit, nën faturim 18.18 % e cila është vlerë shume e lartë dhe e papranueshme.
- Humbjet reale 37.48 % rezultojnë në nivele mjaft të larta që vijnë kryesisht nga rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes 16.95 % dhe të transmetimit 3.08 % por dhe nga riparimet në linjat e ujësllësit që janë në nivelin 13.37 %. Të dy këto komponentë duhet të verifikohen në terren dhe të saktësohen të dhënat mbi nivelin real që ato kanë.

Rekomandime:

- *Shoqëria e ujësjellësit duhet të ndërmarrë një sërë masash të strukturuar dhe të bazuara në praktikën më të mirë të sektorit, me qëllim rritjen e efikasitetit operacional, reduktimin e humbjeve dhe sigurimin e një bilanci të besueshëm të ujit.*
- *Është e domosdoshme përshpejtimi i investimeve të parashikuara për ndërtimin e unazave DMA (District Metered Areas) në rrjetin shpërndarës. Këto zona të mbyllura me matje do të mundësojnë monitorim të lokalizuar, diagnostikim të saktë të humbjeve dhe ndërmarrjen e masave korrigjuese në kohë. Implementimi i DMA-ve është një kusht teknik për hartimin e një bilanci korrekt të ujit dhe për uljen graduale të UPA-së.*
- *Stafi teknik duhet të trajnohet vazhdimisht në programet kombëtare dhe rajonale për menaxhimin e humbjeve të ujit, të organizuara nga SHUKALB dhe institucione të tjera. Për më tepër, duhet të caktohet një person përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, duke siguruar që bilanci i ujit të hartohet mbi bazë të dhënash të verifikuara dhe të standardizuara.*
- *Duke qenë se jo të gjitha burimet e furnizimit janë të pajisura me ujëmatës, investimi në matës prodhimi është i domosdoshëm dhe urgjent. Pa matje të saktë në prodhim, bilanci i ujit nuk mund të jetë i besueshëm. Shoqëria ka kapacitetet financiare për këtë ndërhyrje dhe duhet ta realizojë menjëherë.*
- *Në nivel konsumi, prioritet absolut duhet të jetë pajisja e 100 % e konsumatorëve me ujëmatës individuale, për të mundësuar menaxhim racional të kërkesës dhe minimizim të humbjeve të dukshme. Për zonat rurale dhe shtëpitë private, duhet hartuar një plan veprimi specifik. Për bizneset private, rekomandohet instalimi i ujëmatësve inteligjentë, duke eliminuar gabimet e leximit manual dhe nënfaturimin.*
- *Duke pasur parasysh nivelin e lartë të humbjeve nga pasaktësia në matje dhe nënfaturim (18.18 %), shoqëria duhet të ndërmarrë një plan veprimi për përcaktimin e saktë të konsumit, duke mos lënë hapësirë për abuzime. Një Task-Force e dedikuar duhet të kryejë verifikime në terren për raste të anashkalimit të ujëmatësve, lidhje sekondare apo klientë të paregjistruar. Ky kontroll duhet të përfshijë edhe punën e lexuesve të matësve, për të evidentuar problematikën e ujit të nënfaturuar.*
- *Shoqëria duhet të krijojë dhe të mirëmbajë sisteme të integruara të informacionit, të cilat sigurojnë raportim të saktë dhe të besueshëm për bilancin e ujit dhe çdo informacion tjetër të kërkuar për njësitë administrative. Për çdo lidhje pa matës, faturimi duhet të bëhet mbi bazën e numrit të banorëve të verifikuar me certifikatë familjare, sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*

- Është e domosdoshme rritja e bashkëpunimit me ERRU-në, për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilancit të ujit dhe për të siguruar dorëzimin e tij në kohë. Bilanci duhet të dorëzohet çdo fillim viti për të gjithë zonën e shërbimit. Për këtë, duhet të caktohet një person përgjegjës për monitorimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara.
- Rekomandimet e mësipërme përbëjnë një plan të integruar teknik, i cili kombinon investimet në infrastrukturë, forcimin e kapaciteteve njerëzore, instalimin e ujëmatësve prodhimi dhe konsumi, kontrollin e abuzimeve dhe krijimin e sistemeve të informacionit. Vetëm përmes zbatimit të këtyre masave, shoqëria mund të arrijë reduktimin e ndjeshëm të UPA-së, rritjen e efikasitetit operacional dhe sigurimin e një bilanci të besueshëm të ujit.

18. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Vorë sh.a.

Shoqëria UK Vorë raporton se ka nën juridiksion 41,790 banorë, ndërsa mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë ofrohet për 28,870 banorë. Prodhimi vjetor raportohet në sasinë 3,807,000 m³ ujë, dhe për këtë vit raportohet se 44.76 % e ujit të prodhuar vlerësohet.

Të dhënat e përgjithshme, të raportuara pranë sektorit të monitorimit lidhur me popullsinë e shërbyer, si dhe konsumin për banor/familjar me matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit të Shoqërisë UK Vorë, paraqiten në Tabelën nr. 49.

Analiza e të dhënave të Tabelës nr. 49, bazuar në raportimet e shoqërisë për popullsinë e shërbyer në juridiksionin e saj, tregon se konsumi i matur i ujit rezulton 43.2 litra/ditë për banor, ndërsa konsumi sipas faturimit aforfe arrin në 36.6 litra/ditë për banor. Të dy këta tregues mbeten dukshëm nën standardin referues prej 150 litra/ditë për banor, veçanërisht në rastin e konsumit të matur.

Këto rezultate evidentojnë nevojën që shoqëria të verifikojë dhe përditësojë numrin e popullsisë së shërbyer brenda juridiksionit të saj, me fokus të veçantë tek konsumatorët me dhe pa matës, si dhe tek përfshirja e klientëve joaktivë në raportime. Gjithashtu, për faturimin aforfe, në përputhje me VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma referuese duhet të jetë 150 litra/ditë për banor; në të kundërt, shoqëria duhet të argumentojë dhe dokumentojë arsyet e devijimit nga kjo normë.

Tabela nr. 48. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.UK Vorë	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi I matur në m ³	Konsumi I pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi I pamatur	Konsumi Total
							I/ditë, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
Viti 2025	28,870	440,000	353,000	87,000	4,166	1,212	43.2	36.6	41.8

Duke marrë në konsideratë rritjen e vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe sfidat e pritshme që lidhen me disponueshmërinë e burimeve ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe zhvillimeve demografike, është e nevojshme të kryhet një vlerësim i kapaciteteve ekzistuese të burimeve ujore në raport me kërkesën aktuale dhe atë të parashikuar për ujë. Për këtë qëllim, në Tabelën nr.50 paraqitet një analizë krahasuese ndërmjet volumit të ujit të prodhuar, konsumit total të popullsisë së shërbyer, si dhe burimeve ujore përkatëse dhe kapaciteteve të tyre. Edhe për vitin 2025 janë konsideruar të njëjtat kapacitete të burimeve të ujit të pijshëm, për shkak të mungesës së një vlerësimi të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 49. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

Sh. UK Vorë	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar qe futet ne sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar ne Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca ne Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	28,780	3,807,000	41.8	41,790	9,417,600	+ 617	+ 576

* Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Bazuar në të dhënat e Tabelës nr. 50, konstatohet se Shoqëria UK Vorë disponon burime ujore të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës për ujë në të gjithë zonën e saj të shërbimit.

Në vijim, fokusi strategjik i shoqërisë duhet të jetë mbrojtja dhe menaxhimi i qëndrueshëm i burimeve ujore, nëpërmjet shfrytëzimit sa më efikas të kapaciteteve të disponueshme, optimizimit të prodhimit sipas kërkesës reale për ujë dhe reduktimit të humbjeve në rrjet në të gjitha njësitet përbërëse pasi kjo shoqëri vazhdon të ketë nivelin e UPA (81%) niveli më i lartë në sektor . Këto masa do të kontribuojnë në arritjen e objektivit afatgjatë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë 24/7 për çdo njësi furnizimi, si dhe në garantimin e qëndrueshmërisë së burimeve ujore për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë UK Vorë sh.a.

Shoqëria UK Vorë vijon prej disa vitesh të raportojë nivele të papranueshme të faturimit total. Për vitin në analizë, ky tregues rezulton në nivelin 18.62%, krahasuar me 16.79% në vitin 2024, duke reflektuar një përmirësim të këtij treguesi megjithëse nuk reflekton në përmirësim të performancës. Si pasojë, treguesi “Ujë Pa të Ardhura (UPA)” paraqitet në nivelin 81.38% të prodhimit vlerë që vazhdon prej disa vitesh të mbetet shumë larg standardeve të pranueshme të sektorit. Shoqëria administron gjithsej 6,030 lidhje uji, nga të cilat 4,818 faturohen në bazë të matjes, ndërsa pjesa tjetër vazhdon të faturohet aforfe.

Rrjeti i shpërndarjes së ujit nuk është i organizuar në zona të pavarura matjeje (DMA), duke kufizuar ndjeshëm aftësinë e shoqërisë për monitorimin e humbjeve, identifikimin e problematikave specifike dhe hartimin e strategjive efektive për reduktimin e tyre, me fokus në zonat me performancën më të dobët.

Në Tabelën nr. 51 paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për ish shoqërinë UK Vorë mbi të cilat bazohet analiza e humbjeve të ujit.

Tabela nr. 50. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Vorë sh.a. – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	2,103,000	55.24%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	1,704,000	44.76%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem total	3,807,000	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	622,000	16.34%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	87,000	2.28%
Faturimi total	709,000	18.62%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	121,239	3.18%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	380,773	10.00%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	495,005	13.00%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	706,968	18.57%
Humbjet e dukshme (administrative)	1,582,746	41.57%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	324,195	8.52%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	228,464	6.00%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	133,271	3.50%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	647,315	17.00%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësjellësit	60,771	1.60%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	1,394,015	36.62%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	2,976,761	78.19%
UJI PA TË ARDHURA	3,098,000	81.38%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 51:

- Niveli i UPA prej 81.38 % të prodhim+it vjetor vazhdon ta rendisë shoqërinë ndër subjektet me performancën më të dobët në sektor. Megjithatë, saktësia e këtij treguesi kërkon verifikime të mëtejshme në terren, duke analizuar të dhënat mbi prodhimin, bazën e klientëve, lidhjet e ligjshme dhe të paligjshme, si dhe gjendjen teknike të rrjetit.
- Vlerësimi dhe analiza e humbjeve të ujit nuk realizohen në mënyrë sistematike dhe as në nivel zonash të ndara me matje (DMA), gjë që kufizon identifikimin e burimeve reale të humbjeve dhe planifikimin e masave korrigjuese.

- Nga sasia totale e ujit të prodhuar që futet në sistem, vetëm 55.24% raportohet si e matur, ndërsa pjesa tjetër përcaktohet me vlerësim, duke ulur ndjeshëm besueshmërinë e të dhënave operative.
- Pasaktësitë e mundshme në vlerësimin e sasisë së ujit të prodhuar, mungesa e DMA-ve dhe faktorë të tjerë teknikë krijojnë dyshime mbi saktësinë e volumit të raportuar të ujit dhe, për rrjedhojë, edhe mbi besueshmërinë e treguesit UPA.
- Humbjet teknike, në nivelin 36.62% të prodhimit vjetor, konsiderohen tepër të larta, pavarësisht përmirësimit prej 2.48% krahasuar me vitin 2024. Pjesa më e madhe e këtyre humbjeve lidhet me rrjedhjet në rrjetin e shpërndarjes (17.0%) dhe në linjat e transmetimit (8.52%). Gjithashtu, niveli i humbjeve nga rrjedhjet në burime dhe stacione pompimi mbetet i lartë në 6.0%, duke kërkuar ndërhyrje prioritare.
- Humbjet administrative, në nivelin 41.57% të prodhimit, vlerësohen të papranueshme. Këto lidhen kryesisht me lidhjet e paligjshme në rrjetin e transmetimit (10.0%) dhe shpërndarjes (13.0%), si dhe me pasaktësitë në vlerësimin e ujit të prodhuar dhe nënfaturimin (18.57%). Kjo situatë paraqet rrezik serioz për qëndrueshmërinë financiare dhe operacionale të shoqërisë.
- Aktualisht, 87.73% e konsumit total faturohet me matje, ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Arritja e matjes së plotë (100%) për të gjitha kategoritë e konsumatorëve mbetet një objektiv prioritar për reduktimin e humbjeve administrative, rritjen e saktësisë së faturimit dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të shoqërisë.

Rekomandime:

- *Të ndërmerren veprime për sigurimin e fondeve të nevojshme për projektimin dhe implementimin e sistemeve DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë, megjithëse disa nga investimet kanë nisur. Kjo do të mundësojë monitorimin, diagnostikimin dhe menaxhimin efektiv të humbjeve në sistemin e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci sa më të saktë të ujit.*
- *Të vijojë trajnimi i stafit teknik në kuadër të programeve kombëtare për reduktimin e humbjeve të ujit, të organizuara nga SHUKALB dhe institucione të tjera përkatëse. Gjithashtu, rekomandohet caktimi i një personi përgjegjës për monitorimin, përpunimin dhe verifikimin e të dhënave të raportuara, si dhe për hartimin e bilancit të ujit për çdo DMA dhe për të gjithë zonën e shërbimit.*
- *Duke qenë se aktualisht raportohet vetëm sasia e ujit të blerë e cila matet, ndërsa sasia e ujit të prodhuar vlerësohet, investimi në pajisje matëse në pikat e prodhimit konsiderohet prioritet urgjent. Shoqëria duhet të sigurojë fondet e nevojshme, qoftë nga burime qendrore apo nga burimet e veta financiare, për instalimin e ujëmatësve dhe përmirësimin e saktësisë së bilancit të ujit.*

- *Të sigurohen fonde për rritjen e përqindjes së konsumatorëve familjarë të pajisur me ujëmatës, me synimin e arritjes sa më pranë nivelit 100%. Duke qenë se një pjesë e klientëve familjarë vazhdojnë të furnizohen pa matje të konsumit, instalimi i ujëmatësve do të mundësojë menaxhim më efikas të kërkesës për ujë dhe reduktimin e humbjeve të dukshme. Për këtë qëllim, rekomandohet hartimi dhe zbatimi i një plani veprimi me fokus të veçantë në zonat rurale.*
- *Në funksion të identifikimit dhe reduktimit të lidhjeve të paligjshme, shoqëria duhet të ndërmarrë një plan veprimi për përditësimin dhe verifikimin e bazës së klientëve, duke e krahasuar atë edhe me të dhënat e klientëve të OSHEE-së.*
- *Task-Forca, në bashkëpunim të vazhdueshëm me sektorin e shitjeve, duhet të intensifikojë kontrollet në terren për identifikimin e anashkalimeve të ujëmatësve, lidhjeve dytësore të paautorizuara, klientëve të paregjistruar dhe problematikave që lidhen me ujin e pafaturuar. Gjithashtu, duhet të monitorohet cilësia e procesit të leximit të ujëmatësve.*
- *Të zhvillohen dhe mirëmbahen sistemet e informacionit për të garantuar raportim të saktë, të plotë dhe të besueshëm të të dhënave që lidhen me bilancin e ujit dhe treguesit e performancës. Paralelisht, të planifikohen investime për pajisjen me ujëmatës të gjitha kategorive të konsumatorëve, duke siguruar matjen e konsumit për çdo lidhje që faturohet.*
- *Për lidhjet pa ujëmatës, në rastet kur instalimi i tyre nuk është i mundur, të kryhet verifikimi i numrit të banorëve përmes dokumentacionit përkatës (certifikatë familjare), me qëllim faturimin sipas legjislacionit në fuqi, përfshirë VKM nr. 102, datë 16.03.1992. Gjithashtu, rekomandohet përditësimi i të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe zonën e juridiksionit, për të siguruar analiza më realiste të përdorimit të ujit.*
- *Të forcohet bashkëpunimi me ERRU-në për adresimin e vështirësive në hartimin e bilancit të ujit dhe për dorëzimin e tij brenda afateve të përcaktuara, në fillim të çdo viti raportues.*

19. Analiza e Uji Pa të Ardhura (UPA) për Shoqërinë UK Kamëz sh.a

Shërbimi i furnizimit me ujë në Bashkinë Kamëz ofrohet për 82.9 % të popullsisë në juridiksion. Prodhimi vjetor raportohet 10,229,289 m³ ujë i cili rezulton 100 % i matur. Numri i lidhjeve me rrjetin e ujësjellësit është 33,951 lidhje, ku 85 % e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Të dhëna të përgjithshme, referuar të dhënave të raportuara pranë sektorit të monitorimit, në lidhje me popullsinë e shërbyer, konsumin për banorë/familjarë më matje dhe pa matje në të gjithë zonën e shërbimit, të Sh.A UK Kamëz jepen në tabelën nr. 52.

Nga të dhënat e Tabelës nr.52, analiza e të dhënave të raportuara nga shoqëria pranë sektorit të monitorimit tregon se sasia e ujit të konsumuar të matur në litra/ditë për banor prej 83 l/ditë për banorë, apo sipas faturimit aforfe që rezulton një konsum prej 39.9 l/ditë për banor, në të dy rastet, niveli i konsumit jo vetëm në zbritje krahasuar me 2024, por rezulton dukshëm nën normën orientuese prej 150 litra/ditë për banor, e cila përdoret si standard referues.

Ky rezultat evidenton nevojën për një rivlerësim të bazës së të dhënave mbi popullsinë e shërbyer dhe numrin faktik të banorëve në juridiksionin e shoqërisë. Për këtë qëllim, rekomandohet përdorimi i të dhënave të përditësuara të Censurit 2023, me synim përmirësimin e saktësisë së treguesve të konsumit dhe të procesit të faturimit. Njëkohësisht, është e nevojshme të analizohen faktorët që ndikojnë në nivelet e ulëta të konsumit të raportuar, për të përcaktuar nëse ato lidhen me pasaktësi në regjistrimin e popullsisë, me praktikën e faturimit apo me faktorë të tjerë operacional.

Në veçanti, vlerësim i detajuar duhet t'u kushtohet konsumatorëve pa matës, përfshirë edhe klientët joaktivë që faturohen me tarifë aforfe. Referuar VKM nr. 102, datë 16.03.1992, norma e konsumit për këtë kategori është 150 litra/ditë për banor. Për rrjedhojë, çdo nivel faturimi nën këtë normë duhet të mbështetet me argumentim teknik dhe administrativ, duke dokumentuar arsyet që kanë çuar në devijimin nga standardi.

Tabela nr. 51. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe

Sh.UK Kamëz	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m3	Konsumi i matur në m3	Konsumi i pamatur në m3	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
							l/ditë, banorë	l/ditë, banorë	l/ditë, banorë
Viti 2025	125,308	3,493,000	3,214,000	279,000	26,681	4,649	83.0	39.9	76.4

Referuar tendencës në rritje të vazhdueshme të kërkesës për ujë, si dhe problematikat e pritshme të rezervave ujore për shkak të ndryshimeve klimatike dhe ndryshimeve demografike, duhet bërë një vlerësim i këtyre rezervave në krahasim me plotësimin e kërkesës për ujë, të paktën asaj aktuale. Për këtë qëllim në Tabelën nr. 53, krahas volumit të ujit të prodhuar dhe konsumit total për popullsinë e shërbyer, jepen dhe burimet ujore respektive dhe kapacitetet e tyre. Sqarojmë se vazhdojmë të mbajmë të njëjtën vlera për kapacitetet e burimeve për ujë të pijshëm, pasi nuk ka një vlerësim të përditësuar të tyre.

Tabela nr. 52. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare dhe Disponibiliteti i Burimeve

UK Kamëz	Popullsia* e Shërbyer	Uji i Prodhuar që futet në sistem	Konsumi Total i Matur dhe Aforfe	Popullsia e Regjistruar në Zonën e Shërbimit	Burimi dhe Kapaciteti i Tij	Sasia e Disponueshme e Ujit	Diferenca në Plotësimin e Kërkesës
		(në m ³)	(l/ditë, banor)		(në m ³ /vit)	(l/ditë, banor)	(l/ditë, banor)
Viti 2025	125,308	11,004,000	76.4	151,101	13,824,000	+ 251	+ 174

*Nr. i Popullsisë së shërbyer, dhe i asaj të regjistruar në zonën e shërbimit, sipas raportimit të shoqërisë pranë sektorit të monitorimit ERRU.

Nga tabela nr. 53, shihet se shoqëria UK Kamëz ka burime të mjaftueshme ujore për plotësimin e kërkesës për ujë në zonën e saj të shërbimit. Në fokusin e shoqërisë rajonale duhet të jetë mbrojtja e burimeve nëpërmjet shfrytëzimit me efikasitet të burimeve ujore të disponueshme, duke u bazuar në prodhimin sipas kërkesës për ujë si dhe reduktimin e humbjeve ujit në të gjitha njësitë përbërëse për të arritur dhe qëllimin final “kohëzgjatje të furnizimit me ujë në 24/7” për çdo njësi furnizimi si dhe sigurimin e ujit për brezat e ardhshëm.

UPA për Shoqërinë UK Kamëz sh.a.

Shoqëria UK Kamëz sh.a. raporton se “uji që hyn në sistem” në sasinë 10,229,289 m³ (774,711 m³ më pak se viti 2024), nuk prodhohet tërësisht nga kjo shoqëri, por siç dhe raportohet nga shoqëria rezulton 100 % i matur. Numri i lidhjeve me rrjetin është 33,951 lidhje, ku 85 % e tyre janë të pajisur me ujëmatës ndërsa pjesa tjetër faturohet aforfe. Rrjeti shpërndarës i furnizimit me ujë nuk është i organizuar në zona të pavarura me matje (DMA) e për pasojë shoqëria e ka të vështirë monitorimin e humbjeve të ujit në zonën e shërbimit si dhe ndërtimin e strategjive për zvogëlimin e tyre, me orientim prioriteti në DMA-të me problematike.

“Faturimi total” në vlerë 36.9% nga 32.9 % i raportuar në 2024, ndaj sasisë së ujit të prodhuar, tregon një trend rritës gjatë tre viteve të fundit. “Uji Pa të Ardhura” (UPA) në nivelin 63.1% nga 67.1 % në vitin 2024, me gjithë trendin pozitiv në rënie që ka, referuar tre viteve të fundit, përsëri vlerësohet në nivele të larta dhe të papranueshme.

Rrjetet e furnizimit kanë shtrirje territoriale në zona të reja banimi (dikur toka bujqësore) ku ndërtimet gjatë 30 viteve janë bërë pa kriter e për pasojë rrjetet e furnizimit janë abuzuar nga banorët duke lidhur në to lidhje dyfishe apo të paligjshme. Shoqëria vlerëson humbjet nga lidhjet e paligjshme në rrjet të transmetimit në nivelin 14.47% nga 19.08 % në vitin 2024 ndërsa nga lidhjet e paligjshme në rrjetin shpërndarës rezulton 42.26% nga 40.03 %, nivele këto të papranueshme, sepse rezulton se humbjet administrative megjithëse në nivelin e 58.78% duke rezultuar me një zbritje modeste krahasuar me vitin 2024 që ishin 59.11 % konsiderohen të papranueshme.

Nevoja për eliminim e tyre është emergjente pasi vë në vështirësi financiare shoqërinë UK Kamëz. Shpesh herë janë konstatuar pasaktësi dhe raportim jo korrekt mbi komponentët përbërës të bilancit të ujit, nevoja për trajnim të stafit teknik është e evidente.

Në Tabelën nr. 54, paraqiten komponentët përbërës të Bilancit të Ujit për shoqërinë UK Kamëz mbi bazën e të cilave është kryer Bilanci dhe analiza e humbjeve të ujit.

Tabela nr. 53. Bilanci i Ujit për Shoqërinë UK Kamëz – Viti 2025

Emërtimi	Volumi i Ujit (në m ³)	Në % të Ujit të prodhuar
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i matur	10,229,289	100%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem i vlerësuar	-	0%
Volumi i ujit të prodhuar që futet në sistem	10,229,289	100.00%
Konsumi i ujit të faturuar i matur	3,431,255	33.54%
Konsum i ujit të faturuar i pa matur	343,745	3.36%
Faturimi total	3,777,000	36.90%
Konsumi i autorizuar i pa faturuar	153,300	1.50%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në linjën e transmetimit	1,480,000	14.47%
Humbjet e ujit për shkak të lidhjeve të paligjshme në rrjetin shpërndarës	4,322,600	42.26%
Humbjet e ujit nga pasaktësi në matjen e ujit, nën faturim etj.	210,000	2.05%
Humbjet e dukshme (administrative)	6,012,600	58.78%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në linjat e transmetimit	124,889	1.22%
Humbjet e ujit nga rrjedhjet në stacionin e pompave, burim.	6,500	0.06%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve dhe derdhjeve në depot e ujit	25,000	0.24%
Humbjet e ujit për shkak të rrjedhjeve në rrjetin e shpërndarjes	80,000	0.78%
Humbjet e ujit për shkak të riparimeve në linjat e sistemit të Ujësllësit	52,000	0.51%
Humbjet Reale të ujit (teknike)	288,389	2.82%
Humbjet Totale (Reale dhe të dukshme)	6,300,989	61.60%
UJI PA TË ARDHURA	6,454,289	63.10%

Komente mbi të dhënat e Tabelës 54:

- UPA vazhdon të ketë një trend zbritës prej afërsisht 4% referuar viteve të fundit, por nivel prej 63.1 % sërish rezulton në nivele të pakënaqshme dhe të pa tolerueshme.
- Humbjet administrative në nivelin 58.78% të prodhimit shkaktohen nga lidhjet e paligjshme në rrjetet e transmetimit (14.47 %), në shpërndarje (42.26 %) dhe nga pasaktësi në matjen e ujit e nën faturim (2.05%). Megjithatë më të ulëta se viti 2024 këto humbje konsiderohen mjaft të larta dhe të papranueshme pasi kanë një impakt financiar negativ dhe rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të shoqërisë.
- Humbjet teknike në nivelin 2.82% rezultojnë kryesisht nga rrjedhjet në linjën e transmetimit (1.22 %) të cilat rezultojnë pak më të ulëta se në vitin 2024. Shoqëria duhet të analizojë situatën në terren për verifikimin dhe saktësimin e të dhënave që raportohen.

Rekomandime:

- *Të bëhen përpjekje për sigurimin e fondeve për të projektuar dhe zbatuar sisteme DMA në të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë që mundëson një monitorim, diagnostikim dhe marrjen e masave për uljen e humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë, si dhe hartimin e një bilanci korrekt të ujit.*
- *Shoqëria duhet të investojë realisht në burimet njerëzore përgjegjëse për monitorimin, përpunimin dhe saktësimin e të dhënave të raportuara, për hartimin e bilanci të ujit për çdo DMA ekzistuese si dhe për të gjithë zonën e shërbimit të shoqërisë rajonale. Gjithashtu të insistohet që Bilanci i Ujit të trajtohet jo thjesht si një statikë por si analizë reale që evidenton gjithë problematikën që shoqëria ka lidhur me sistemet e ujësjellësit.*
- *Shoqëria bazuar në plane të hartuara veprimi duhet të alokojë fonde për të rritur përqindjen e konsumatorëve familjare me matës dhe të gjithë kategorive të konsumatorëve që ky tregues të jetë sa më afër nivelit 100%, për të mundësuar një menaxhim racional të kërkesës për ujë, si dhe minimizimin e humbjeve të dukshme.*
- *Shoqëria duhet të ndërmarrë urgjentisht masa lidhur me përqindjen e lartë të lidhjeve të paligjshme në linjat e transmetimit, duke përcaktuar sa më saktësisht bazën e klientëve bazuar duke filluar nga DMA-të më problematike të UK Kamëz.*
- *Task- Forca vazhdimisht e në bashkëpunim me degën e shitjes, të jetë në veprim në terren me verifikime në vend për anash kalim të ujëmatësit me lidhje dytësore apo klientë të paregjistruar me kontratë me shoqërinë, si kontroll i punës së lexuesve të matësave dhe në përgjithësi për evidentimin e problematikës me ujin e nën faturuar. Për çdo lidhje pa matës, në pamundësi për vendosjen e matësit, nëpërmjet faturuesve duhet të verifikohet numri i banoreve (certifikatë familjare) për çdo lidhje dhe më pas të faturohen sipas VKM nr.102, datë 16.03.1992.*
- *Të krijojë dhe të mirëmbajë të gjitha sistemet e informacionit, për të patur raportim të saktë dhe të besueshëm të të dhënave të kërkuara, në lidhje me bilancin e ujit dhe çdo informacioni tjetër që mund të kërkohej.*
- *Bashkëpunim sa më koherent dhe efektiv i shoqërisë me institucionin e ERRU-së, për të tejkaluar vështirësitë në hartimin e bilanci të ujit të saktë dhe real si dhe dorëzimi i tij në afatet kohore dhe sipas kërkesave pranë ERRU-së, do të ndikojë drejtpërdrejt në hartimin e një raporti real vlerësimi të ujit pa të ardhura dhe humbjeve të ujit.*

ANEKSI 1. Konsumi i Faturuar për Konsumatorët Familjare me Matje dhe Aforfe 2025

Nr	Shoqëritë	Popullsia me shërbim	Konsumi total në m ³	Konsumi i matur në m ³	Konsumi i pamatur në m ³	Nr. lidhjeve me matës	Nr. lidhjeve pa matës	Konsumi i matur	Konsumi aforfe	Konsumi Total
								I/ditë, banor	I/ditë, banor	I/ditë, banor
1	Sh.R. UK Berat	160,305	3,896,627	3,716,348	180,279	36,613	2,872	68.5	4.2	66.6
2	Sh.R. UK Elbasan	262,622	6,919,000	6,224,000	695,000	57,530	5,844	71.5	78.6	72.2
3	Sh.R. UK Dibër	94,316	3,001,000	1,902,000	1,099,000	16,416	6,109	75.8	117.7	87.2
4	Sh.R. UK Durrës	506,727	10,711,799	9,628,302	1,083,497	123,204	6,371	54.7	119.1	57.9
5	Sh.R. UK Fier	202,120	5,100,060	3,822,040	1,278,020	41,272	9,258	63.4	94.6	69.1
6	Sh.R. UK Gjirokastrë	114,332	3,155,310	2,208,250	947,060	21,521	7,048	70.2	92.0	75.6
7	Sh.R. UK Korçë	223,859	4,540,231	4,478,723	61,508	50,970	1,205	57.1	18.6	55.6
8	Sh.R. UK Kukës	49,292	1,675,200	787,800	887,400	6,408	5,075	78.5	111.6	93.1
9	Sh.R. UK Lezhë	118,859	2,707,000	2,242,000	465,000	26,904	3,012	61.0	70.1	62.4
10	Sh.R. UK Lushnjë	109,496	2,619,020	2,613,530	5,490	27,348	26	65.5	144.6	65.5
11	Sh.R. UK Pogradec	106,138	2,187,810	2,133,340	54,470	25,365	795	56.8	46.3	56.5
12	Sh.R. UK Sarandë	100,080	2,346,400	2,250,800	95,600	26,662	1,437	64.9	51.2	64.2
13	Sh.R. UK Shkodër	180,533	4,115,742	2,472,905	1,642,837	32,275	9,946	49.1	105.8	62.5
14	Sh.R. UK Vlorë	222,375	5,455,000	3,347,000	2,103,000	49,889	16,894	55.2	102.4	67.1
15	UK Tiranë	943,597	27,226,000	23,882,600	3,343,400	224,677	22,781	76.4	105.4	79.1
16	UK Vorë	28,870	440,000	353,000	87,000	4,166	1,212	43.2	36.6	41.8
17	UK Kamëz	125,308	3,493,000	3,214,000	279,000	26,681	4,649	83.0	39.9	76.4
	Total	3,548,829	89,589,199	75,276,638	14,307,561	797,901	104,534	65.73	95.22	69.2

ANEKSI 2. Tabela Përmbledhëse e Bilancit të Ujit për çdo Shoqëri viti 2025

Nr	Shoqëritë	Volumi vjetor i ujit të prodhuar që futet në sistem (m³)		Faturimi Total (m³)	Konsumi i Autorizuar i pafaturuar (m³)	Humbjet administrative (m³)	Humbjet teknike (m³)	Humbjet Totale (m³)	Uji pa të ardhura (UPA) (m³)	Uji pa të ardhura (UPA) (%)
		I matur	I vlerësuar							
1	Berat-Kuçovë		5,686,555	4,496,393	770,141	666,984	1,261,339	1,928,323	2,698,464	37.51
2	Dibër	0	5,491,000	3,607,000	105,700	1,101,500	557,650	1,659,150	1,764,850	32.14
3	Durrës	21,204,567	31,387,433	16,647,796	0	14,893,425	21,050,778	35,944,203	35,944,203	68.35
4	Elbasan	19,430,340	2,427,660	7,974,000	1,000,100	6,894,580	5,989,320	12,883,900	13,884,000	63.52
5	Fier	15,804,410	0	5,961,610	310,000	6,955,298	2,577,000	9,532,298	9,842,298	62.27
6	Gjirokastrë	3,749,000	2,419,000	3,644,160	46,000	450,000	2,027,528	2,477,528	2,523,528	40.91
7	Korçë	6,921,230	960,000	5,222,196	77,132	987,827	1,594,271	2,582,098	2,659,230	33.74
8	Kukës	762,300	2,771,517	2,001,800	78,468	655,002	798,547	1,453,549	1,532,017	43.35
9	Lezhe	5,008,881	2,146,664	3,296,000	5,689	3,306	3,850,392	3,853,698	3,859,387	53.94
10	Lushnje	6,492,640	0	2,979,388	122,929	1,104,751	2,285,573	3,390,324	3,513,253	54.11
11	Pogradec	3,010,859	708,731	2,419,320	50,124	208,848	1,041,306	1,250,154	1,300,278	34.96
12	Sarandë	4,602,000	1,115,000	3,108,160	57,170	725,098	1,826,780	2,551,878	2,609,048	45.64
13	Shkodër	295,260	12,705,500	4,982,335	41,556	6,964,663	1,012,311	7,976,974	8,018,530	61.68
14	Tiranë	68,556,501	37,272,551	39,404,800	138,805	26,621,844	39,782,364	66,404,208	66,543,013	62.77
15	Vorë	2,103,000	1,704,000	709,000	121,239	1,580,209	1,397,285	2,977,494	3,098,733	81.38
17	Kamëz	10,229,289	0	3,775,000	153,300	6,012,600	288,500	6,301,100	6,454,400	63.10
16	Vlorë	0	26,010,000	7,078,000	5,000	9,222,695	9,704,305	18,927,000	18,932,000	72.79
Totali		169,678,579	132,805,611	117,306,958	3,083,353	85,048,630	97,045,249	182,093,879	185,177,232	61.00